

Ministri Ismaili paralajmëron masa ndaj punëtorëve të papërgjegjshëm



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

I PAPRANUESHËM ËSHTË DIALOGU QË U SHËRBEU VETËM INTERESAVE TË SERBISË F. 11



Ismajl KURTESHI

THAÇI DHE HOXHAJ MIRËPRESIN MARRJEN E PRESIDENCËS SË BE-SË NGA AUSTRIA F. 2

TAHIRI: GJYOTARËT DHE PROKURORËT DO T'I KENË PAGAT MË TË DINJITESHME NË RAJON F. 6

EKONOMI

SHPENZIMET QEVERTARE SHËNOJNË RITJE 12 PËR QIND F. 9

SHTESAT PËR FËMIJË PRITET TË JENË NGA 10 DERI NË 40 EURO NË MUAJ F. 9

KULTURË

NJË ZË ARBËROR VJEN NGA SKANDINAVIA F. 10

Berat LUZHA

SPORT

PËRFUNDUAN LOJËRAT MESHETARE, PARAQITJE E MIRË E KOSOVËS F. 18

RUSIA ELIMINON SPANJËN

F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE" KRYETARI I HANIT TË ELEZIT, RUFKI SUMA F. 4-5

Qeveria t'i ketë prioritet zonat kufitare

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës t'i trajtojë me më prioritet zonat kufitare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se komuna që drejton ka nevojë për mbështetje më të madhe nga Qeveria. Suma ka thënë se Komuna e Hanit të Elezit ende nuk ka mbështetje nga Qeveria për ndonjë projekt konkret. "Nga cilado qeveri, qoftë e udhëhequr nga PDK-ja, LDK-ja apo tash nga AAK-ja, ne kemi marrë përkrahje mesatare", ka thënë Suma. Sipas tij, Qeveria mund t'i ndihmojë qytetarët e kësaj komune duke hapur disa pika të përkohshme kufitare. Suma ka treguar se këto pika të përkohshme kufitare do ta lehtësonin qarkullimin e njerëzve për t'i punuar tokat që i kanë përtej kufirit

Analistët: Formimi i ushtrisë përmes ndryshimeve kushtetuese, i pamundur

Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri përmes ndryshimeve kushtetuese tani për tani është i pamundur. Kështu kanë vlerësuar të dielën për gazetën

"Epoka e re", analisti politik Behxhet Shala dhe njohësi i çështjeve të sigurisë, Kadri Kastrati. Ata kanë thënë se aktualisht është shumë e vështirë të bindet komuniteti serb për t'i



votuar ndryshimet kushtetuese. Sipas tyre, FSK-së mund t'i ndryshohet mandati edhe përmes ligjit, por një gjë e tillë nuk po mbështetet nga ndërkombëtarët

SOT I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT VEPRIMTARIT TË ÇËSHTJES KOMBËTARE, BAJRUSH BEHRAMI

Ndërron jetë atdhetari Bajrush Behrami



Ka ndërruar jetë në moshën 61-vjeçare Bajrush Behrami, veprimtar i shquar i çështjes kombëtare shqiptare. Ai ka qenë një prej organizatorëve kryesor të demonstratave të vitit 1981 dhe kishte vuajtur nëntë vjet

burgim. Vdekja e hershme e Behramit, përpos familjarëve, ka lënë të pikëlluar miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij. Varrimi i Behramit do të bëhet sot (e hënë) në orën 17:00 në varrezat e qytetit të Besianës F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Pritren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi dhe Hoxhaj mirëpresin marrjen e presidencës së BE-së nga Austria

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka falënderuar kryeministrin bullgar Boyko Borissov për atë çfarë ka bërë sa Bullgaria kishte presidencën e Bashkimit Evropian, por ka thënë se ka besim të plotë edhe në kancelarin austriak Sebastian Kurz, shteti i të cilit tash ka presidencën. Thaçi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ka besim të plotë në vizionin dhe energjinë e kancelarit austriak Sebastian Kurz. Presidenti ka theksuar se Kosova duhet ta vazhdojë zbatimin e reformave të rëndësishme politike dhe ekonomike, të nevojshme në rrugën e pakthyeshme drejt anëtarësimit në BE.

"Presidenca e BE-së nga Bullgaria dhe Samiti i Sofjes ishin një sukses i plotë dhe një hap i madh përpara drejt jetësimit të aspiratës sonë për anëtarësim në BE. E falënderoj kryeministrin bullgar Boyko Borissov për rolin dinamik në mbështetje të shteteve të Ballkanit Perëndimor, në gjashtë muajt e fundit të kryesimit të presidencës. Presidencën e BE-së tani e merr një shtet tjetër mik i Kosovës, Austria. Unë kam besim të plotë në vizionin dhe energjinë e kancelarit austriak Sebastian Kurz për ta shtyrë përpara agjendën evropiane të shtetit tonë dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor. Ne duhet ta vazhdojmë zbatimin e reformave të rëndësishme




politike dhe ekonomike, të nevojshme në rrugën e pakthyeshme drejt anëtarësimit në BE", ka shkruar Thaçi.

Edhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka uruar kancelarin Kurz për marrjen e presidencës së BE-së, duke e cilë-

suar këtë si "momentum për Kosovën dhe vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën drejt BE-së".

Kosova bëhet anëtare me të drejta të plota në OBD



BRUKSEL, 1 KORRIK (ER) - Republika e Kosovës ka marrë pjesë në sesionin e 132-të të Këshillit të Organizatës Botërore të Doganave (OBD), e cila po mbahet në Bruksel me pjesëmarrje nga 182 shtete anëtare. Ky ishte sesioni i 4-të i OBD-së në të cilin Kosova po merr pjesë si anëtare që nga janari i vitit 2017.

Në kuadër të këtij sesioni është rizgjedhur sekretar i përgjithshëm i OBD-së, Kunio

Mikuriya. Po ashtu, është diskutuar rishikimi i Konventës së Kyotos, ndërtimi i kapaciteteve, programeve për lehtësim të tregtisë që do t'u ofrohen shteteve anëtare dhe çështje të tjera të rëndësishme në fushëveprimin doganor.

Gjatë punimeve të sesionit, Republika e Kosovës ka ushtruar të drejtat sikurse të gjitha vendet e tjera anëtare, duke marrë fjalën, ushtruar të drejtën e votës dhe duke u konfirmuar

nga Këshilli buxheti për kontributet financiare të Kosovës. Pavarësisht prej përpjekjeve të Serbisë dhe Rusisë për ta penguar pjesëmarrjen e Kosovës, ato dështuan pas reagimit të delegacionit të Republikës së Kosovës dhe shteteve aleate dhe partnere.

Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka thënë se pavarësisht prej përpjekjeve të Serbisë për ta penguar pjesëmarrjen e Kosovës në OBD, del-

egacioni i Kosovës i ka ushtruar të drejtat dhe obligimet sikurse të gjithë anëtarët e tjerë.

Pacolli ka uruar zgjedhjen e sekretarit të përgjithshëm Kunio Mikuriya nga Japonia dhe të kryesuesit të Këshillit Enrique Cannon nga Uruguai. "Përpjekjet tona nuk do të ndalen asnjëherë për të bërë Kosovën një anëtare të plotë dhe të barabartë të bashkësisë ndërkombëtare", ka thënë ministri Pacolli.

Emergjencia e QKUK-së pranoi 160 raste për 24 orë

PRISHTINË, 1 KORRIK - Menaxhmenti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) përmes një komunikate për medie ka njoftuar se është i vetëdijshëm lidhur me vështirësitë dhe ngarkesën e madhe me pacientë nëpër të cilat po kalon Klinika Emergjente në QKUK.

ShSKUK-ja ka bërë me dije se si rezultat i kësaj situatë janë ndërmarrë hapa për renovim, krijim të prioriteteve për pacientët, blerja e pajisjeve të reja, furnizimin me barna dhe ofrimin e shërbimeve më kual-

itative. "Aktualisht, Klinika Emergjente e QKUK-së ka qenë dhe mbetet e mbingarkuar 24 orë me pacientë, përfshirë raste të aksidenteve në trafik, reanimime, raste të rënda kirurgjike, ortopedike dhe internistike. Përkundër mbingarkesës së madhe, ekipet shëndetësore të Klinikës Emergjente, në konsultim edhe me specialistët kujdestarë nga degët kirurgjike, internistike dhe ortopedike, kanë ofruar ndihmën mjekësore për të gjithë pacientët", është thënë në komunikatën e SHSKUK-së.

Sipas kësaj komunikate, një

pjesë e Klinikës Emergjente është në rinovim, investim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe ShSKUK-së, përderisa për herë të parë nga paslufta janë blerë 300 mijë euro pajisje të reja që pritet të futen në punë pas rinovimit, me kërkesë të menaxhmentit të klinikës. "Duhet theksuar se shqetësim për Klinikën Emergjente paraqet fakti se një numër i madh i pacientëve paraqiten për ndihmë mjekësore direkt në emergjencë, pa konsultuar paraprakisht qendrat e mjekësisë familjare", është theksuar në komunikatën e ShSKUK-së.



Gjermania kërkon fuqi punëtore në sektorin e shëndetësisë nga Kosova dhe Shqipëria

Ministri i Shëndetësisë në Gjermani, Jens Spahn, dhe kolegët e tij kanë kritikuar procedurën e stërzgatur për viza pune në Kosovë dhe Shqipëri

BERLIN, 1 KORRIK - Ministri gjerman i Shëndetësisë, Jens Spahn, do të kërkojë ndihmë në Evropën Juglindore për zgjidhjen e problemit me mungesën e personelit në shëndetësi. Ai ka thënë për gazetën gjermane "Bild am Sonntag" se, në veçanti në Kosovë dhe Shqipëri, ka një potencial shumë të lartë të fuqisë së re punëtore. "Përgatitja e personelit atje është shpesh më e mirë se sa mendojmë ne, por ka shumë probleme të mëdha me dhënien e vizave. Ajo që nuk mund të kuptoj fare është se këta persona të përgatitur dhe të shkolluar duhet të presin shpesh deri në dhjetë muaj për një vizë për Gjermani. Këto procedura duhet të përshpejtohen. Po ashtu, edhe njohja e diplomave zgjatë tepër gjatë", ka thënë ministri Spahn, duke shtuar se duhet të kërkojnë personel

edhe jashtë vendit. Spahn ka pohuar se Gjermania ka nevojë për rreth 50 000 persona që punojnë në shëndetësi dhe sektorin e përkujdesjes për të moshuarit. "Duhet të kërkojmë ndihmë në vendet jashtë Gjermanisë", ka thënë ai, duke shtuar se në Gjermani nuk ka më gati asnjë spital apo institucion për përkujdesjen që të mos ketë fuqi punëtore nga vendet e tjera. Ministri i Punës, Hubertus Heil (SPD), planifikon të fusë të drejtën që të huajt të marrin vizë për gjashtë muaj me qëllim që të kërkojnë punë në Gjermani. "Të huajt që duan të punojnë në sektorin e përkujdesjes do të duhej të marrin vizë për gjashtë muaj dhe të vijnë në Gjermani. Kushti: ata nuk mund të marrin asnjë cent nga sistemet sociale, e nëse as pas gjashtë muajve nuk kanë



gjetur ndonjë vend pune, atëherë duhet të kthehen në vendin e tyre", ka thënë Heil për të njëjtën gazetë.

Ministri gjerman i Shëndetësisë, Jens Spahn, ka bërë me dije para disa ditësh se ai dhe ministri Heil dhe

ministrja e Familjes, Franziska Giffey (SPD), do të nisin një aksion të koncentruar për përkujdesjen. Partitë e Unionit dhe socialdemokratët kanë rënë dakord në programin e tyre qeverisës që t'i përmirësojnë kushtet për përgatitjen pro-

fesionale, informimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në këtë sektor. Heil ka bërë me dije se pagat për personat që punojnë në fushën e kujdesit për të moshuarit të rriten dukshëm deri në mes të vitit të ardhshëm. (bc/sti/qu (afp, dpa)

Rishpallet konkursi për drejtor të Policisë së Kosovës

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka rishpallur sot (e hënë) konkursin për drejtor të përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit. Aktualisht ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës është Naim Rexha

**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 1 KORRIK - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka rishpallur konkursin për drejtor të përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Konkursi do të jetë i hapur nga data 2 korrik deri më 16 korrik. Mandati i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës do të jetë pesë vjet, me mundësi vazhdimi pas çdo pesë (5) vjetëve nga autoriteti që e emëron. "Ministria e Punëve të Brendshme i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ajo i inkurajon aplikacionet prej femrave dhe meshkujve dhe, pa dyshim, inkurajon të gjitha grupet etnike minoritare në Kosovë", është bërë me dije në konkursin e MPB-së.

Funksionet dhe përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës përbëhen nga tetë pika: 1. Drejtori i

Përgjithshëm i Policisë së Kosovës është përgjegjës që të udhëheqë, kontrollojë dhe mbikëqyrë policinë, të menaxhojë dhe shpërndajë buxhetin e policisë në përputhje me objektivat dhe qëllimet strategjike të përcaktuara nga Ministri; 2. Siguron zbatimin e politikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme për Policinë e Kosovës; 3. Ofron këshilla të paanshme profesionale mbi çështjet administrative për Ministrin, si dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me policinë; 4. Struktura e brendshme organizative e Policisë së Republikës së Kosovës propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe aprovet nga Ministri; 5. Me miratimin e ministrit të MPB-së, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës mund të themelojë njësi policore të përkohshme për të kryer detyra të veçanta; 6. I ofron ministrit



informata dhe raporte për Policinë e Kosovës sipas mënyrës së përcaktuar me Ligj; 7. Zbaton politika jodiskriminuese për stafin e Policisë, përfshirë përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet dhe siguron përfaqësim shumë etnik të personelit; dhe

8. Kryen punë të tjera të parapara me ligj, rregullore, apo udhëzime dhe urdhra të ligjshme.

Konkursi për drejtor të përgjithshëm të Policisë së Kosovës ishte shpallur më datë 8. 5. 2018, por ky konkurs është anuluar për shkak të disa shkel-

jeve. Aktualisht, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës është Naim Rexha. Drejtor i deritanishëm i Policisë së Kosovës ka qenë Shpend Maxhuni, i cili tashmë është emëruar në krye të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI).

Flet për "Epokën e re" kryetari i Hanit të Elezit, Rufki Suma

Qeveria t'i ketë prioritet



Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës t'i trajtojë me më prioritet zonat kufitare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se komuna që drejton ka nevojë për mbështetje më të madhe nga Qeveria. Suma ka thënë se Komuna e Hanit të Elezit ende nuk ka mbështetje nga Qeveria për ndonjë projekt konkret. "Nga cilado qeveri, qoftë e udhëhequr nga PDK-ja, LDK-ja apo tash nga AAK-ja, ne kemi marrë përkrahje mesatare", ka thënë Suma. Sipas tij, Qeveria mund t'i ndihmojë qytetarët e kësaj komune duke hapur disa pika të përkohshme kufitare. Suma ka treguar se këto pika të përkohshme kufitare do ta lehtësonin qarkullimin e njerëzve për t'i punuar tokat që i kanë përtej kufirit

pika të rregullta kufitare. Ato mund të jenë të përkohshme vetëm për shkak të punimit të tokave, sepse banorët e kësaj komune kanë toka edhe në territorin e Maqedonisë. Pra, për ta lehtësuar qarkullimin për t'i punuar tokat do të ishte mirë hapja e ndonjë pike kufitare, qoftë edhe për disa orë gjatë ditës", ka thënë Suma.

I pari i kësaj komune ka deklaruar se është në pritje të mbështetjes së Qeverisë për disa projekte. "Ne kemi bashkëpunim normal me qeverinë qendrore. Jam takuar disa herë me kryeministrin dhe me ministra të caktuar. Ende nuk kemi mbështetje nga qeveria qendrore për ndonjë projekt konkret. Deri më tani kemi pasur vetëm premtime. Pra, gjatë këtij viti ende nuk kemi pasur asnjë mbështetje konkrete prej nivelit qendror.

Ne mbesim me shpresë që me rishikimin e buxhetit që do të bëhet mund të marrim ndonjë mbështetje, nëse jo, gjithçka do të varet prej buxhetit tonë komunal", është shprehur ai. Suma ka bërë me dije se të gjitha projektet që i ka premtuar para qytetarëve për këtë mandat kanë filluar të realizohen. "Ato zotime që i kemi bërë para qytetarëve janë realizuar ose janë në realizim e sipër", ka thënë Suma.

"Epoka e re": Z. Suma, ka disa muaj që keni filluar mandatin e tretë qeverisës në Komunën e Hanit të Elezit. Keni filluar t'i realizoni projektet e juaja për këtë mandat?

Suma: Unë nuk kam dëshirë të bëj premtime nëpër fushata por, megjithatë, ne kemi treguar atë që kemi synuar ta realizojmë. Projektet të cilat

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 KORRIK - Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ka bërë me dije se Qeveria duhet ta mbështesë më shumë këtë komunë meqenëse i përket zonës kufitare. Ai ka thënë se deri më tani kjo komunë nga asnjë qeveri nuk është mbështetur sa duhet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Suma ka

thënë se Qeveria duhet t'i ketë prioritet zonat kufitare. "Realisht, meqenëse jemi zonë kufitare, Qeveria duhet t'i japë prioritet kësaj komune më shumë. Për shembull, duhet ta forcojë ndriçimin publik, hyrja në kufi duhet të jetë më e theksuar dhe më e fortë, sepse kjo është hyrja për në Kosovë. Nëse këtu nuk do të kemi një ndriçim, i jep hije jo të mirë gjithë Kosovës. Megjithatë, nuk kemi pasur diçka konkrete.

Gjithë atë ndriçim që ekziston e kemi bërë me mjetet komunale", ka thënë Suma. Po ashtu, ai ka kërkuar ndihmën e Qeverisë edhe për hapjen e pikave të përkohshme kufitare për t'i ndihmuar fshatarët që kanë prona andej kufirit. "Si zonë kufitare kemi nevojë për hapjen e ndonjë pike kufitare të përkohshme. Këtu Qeveria mund të na ndihmojë. Nuk do të thotë se këto pika kufitare mund të jenë

zonat kufitare



Për dijeninë e opinionit, kamerat në zonën urbane i kemi vendosur që disa vjet. Gjithashtu, po vazhdojmë projektin e ndërrimit të laptopëve për të gjithë mësimdhënësit. Në përgjithësi puna po shkon mirë. Ngecje kemi vetëm në projektet që kanë qenë të varura prej Qeverisë qendrore. Vlen të përmendet këtu rasti i pastrimit të lumit Lepenc nga mbetjet e azbestit, i cili ka qenë një projekt me vlerë mbi një milion euro. Ky projekt nuk është realizuar ende, madje më shumë kemi dëme nga ky projekt sesa përfitime. Tani mbetjet e azbestit vetëm sa kanë dalë mbi sipërfaqe, ku tashmë është dëmtuar në tërësi një stadium i futbollit, kanalizimet dhe rrugët.

"Epoka e re": Deri më tani të gjitha zotimet që i keni dhënë para qytetarëve janë duke u realizuar?

Suma: Ato zotime që i kemi bërë para qytetarëve janë realizuar ose janë në realizim e sipër.

"Epoka e re": Cili është bashkëpunimi juaj me Qeverinë? A jeni të kënaqur me përkrahjen?

Suma: Ne kemi bashkëpunim normal me qeverinë qendrore. Jam takuar disa herë me kryeministrin dhe me ministratë taktuar. Ende nuk kemi mbështetje nga qeveria qendrore për ndonjë projekt konkret. Deri më tani kemi pasur vetëm premtime. Pra, gjatë këtij viti ende nuk kemi pasur asnjë mbështetje konkrete prej nivelit qendror. Ne mbesim me shpresë që tash, me rishikimin e buxhetit, do të marrim ndonjë mbështetje, nëse jo atëherë gjithçka do të varet prej buxhetit tonë komunal.

"Epoka e re": Çfarë keni kërkuar nga Qeveria që pritni t'ju mbështesë?

Suma: Kemi kërkuar të na ndihmojë në asfaltimin e rrugës Dromjak - Neçavc. Për këtë projekt Qeveria na ka premtuar mbështetje, por ende nuk ka ndarë mjete buxhetore. Në takimin që kemi pasur me zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës na kanë thënë se është në pritje të nënshkrimit të memorandumit për bashkëpunim. Ata zotohen se do të ndajnë mjete për këtë projekt. Mandej është rehabilitimi i rrugës Han i Elezit - Gorancë, që ishte edhe rruga transit që është shfrytëzuar tani për shkak të bllokadës që

ishte. Ai projekt kushton më shumë se 100 mijë euro. Ky ka qenë një premtim i Ministrisë së Infrastrukturës dhe për këtë jemi në pritje. Pra, këto janë dy premtimet e qeverisë për komunën tonë.

"Epoka e re": Prej kohës që keni marrë postin e kryetarit të kësaj komune, ju keni bashkëpunuar me disa kryeministra. Ka qenë i njëjtë çdoherë bashkëpunimi?

Suma: Bashkëpunimi ynë me të gjitha qeveritë ka qenë pothuajse i njëjtë. Deri më tani asnjë udhëheqës i Qeverisë nuk mund të themi se e ka ndihmuar shumë Hanin e Elezit. Prej të gjitha udhëheqësive të Qeverisë kemi marrë përkrahje mesatare për projekte të caktuara infrastrukture. Cilado qeveri që ka ardhur, e udhëhequr nga PDK-ja, LDK-ja apo tash nga AAK-ja, ne kemi marrë përkrahje mesatare.

"Epoka e re": Domethënë, nuk ka pasur ndonjë pengesë pse ju keni qenë dhe jeni kryetar i pavarur?

Suma: Jo. Me asnjë Qeveri nuk kemi pasur probleme politike. Nuk mund të them se Qeveria e shkuar e ka bllokuar Hanin e Elezit apo kjo tjetra po e përkrah më shumë se qeveritë paraprake. Për neve të gjitha qeveritë kanë qenë të njëjta.

"Epoka e re": Por meqenëse jeni zonë kufitare, do të duhej mbështetje më e madhe nga Qeveria qendrore.

Suma: Meqenëse jemi zonë kufitare Qeveria duhet t'i japë prioritet kësaj komune më shumë. Për shembull, duhet ta forcojë ndriçimin publik, hyrja në kufi duhet të jetë më e theksuar dhe më e fortë, sepse kjo është hyrja për në Kosovë. Nëse këtu nuk do të kemi një ndriçim, i jep hije jo të mirë gjithë Kosovës. Megjithatë, nuk kemi pasur diçka konkrete. Gjithë ndriçimi që ekziston e kemi bërë me mjetet komunale. Si zonë kufitare kemi nevojë për hapjen e ndonjë pike kufitare të përkohshme. Këtu Qeveria mund të na ndihmojë. Nuk do të thotë se këto pika kufitare mund të jenë pika të rregullta kufitare. Ato mund të jenë të përkohshme, vetëm për shkak të punimit të tokave, sepse banorët e kësaj komune kanë toka edhe në territorin e Maqedonisë. Pra, për të lehtësuar qarkullimin për t'i punuar tokat do të ishte mirë hapja e ndonjë pike kufitare, qoftë edhe për disa orë gjatë ditës.

Veseli thotë se PDK-ja është adresa e vetme politike për të rinjtë

"Nuk ka adresë politike e cila ekziston në Republikën e Kosovës që u jep më shumë hapësirë të rinjve sesa Partia Demokratike e Kosovës. Merrni vetëm shikoni sot bartësit e përgjegjësive në Qeverinë e Kosovës", ka thënë kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, në Kuvendin Zgjedhor të Rinisë Demokratike në Malishevë

**EPOKA
E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka marrë pjesë në Kuvendin Zgjedhor të Rinisë Demokratike në Malishevë, ku ishin të pranishëm qindra të rinj të kësaj komune që i janë bashkuar vizionit të kreut të PDK-së për Dekadën e Re. Ai ka thënë se marrja e përgjegjësive politike nga rinia është garanci e transformimit dhe zhvillimit të shtetit të Kosovës. "Është dekada e dytë e shtetit tonë, është dekada e tretë e lirisë, është momenti më vendimtar për kombin tonë, për shtetin tonë, në drejtimin që do ta marrë Kosova jonë. Kjo është shumë me rëndësi. Prej punëve që do të bëjmë në 10 vjetët e ardhshëm do të varet jeta juaj, jeta e familjes suaj, situata e qytetit tuaj, në të njëjtën kohë do të varet se si do të jetë Kosova jonë e përbashkët. Për këtë arsye, është shumë me rëndësi kjo pjesëmarrje kaq masive e rinisë. Unë kur shoh kaq shumë të reja e të rinj të cilët e kanë entuziazmin dhe përgjegjësinë për t'u veshur me petk të përgjegjësive, është shumë me rëndësi për vendin", ka thënë Veseli.

Ai ka bërë me dije se rreth 20

mijë të reja e të rinj anekënd Kosovës janë futur në procesin zgjedhor në PDK. "Kjo është mrekulli. Kjo është e jashtëzakonshme, jo vetëm për një parti politike, por për një vend, për arsye se politika është mjete përmes të cilit më së shumti mund t'i ndihmohet vendit tënd", ka thënë Veseli. Ai ka shtuar se PDK-ja në Dekadën e Re do ta ketë vizion transformimit ekonomik dhe mbështetjen e ideve inovatore të të rinjve për zhvillimin e ndërmarrësisë. "Unë besoj tek ju dhe do t'ju jap përkrahje. Do ta keni përkrahjen e plotë. Nuk ka adresë politike e cila ekziston në Republikën e Kosovës që u jep më shumë hapësirë të rinjve sesa Partia Demokratike e Kosovës. Merrni vetëm shikoni sot bartësit e përgjegjësive në Qeverinë e Kosovës. Shumë e shumë kuvende komunale të cilat i kemi përfaqësuesit tanë, i kemi pikërisht nga rinia. Vazhdoni besimin në Partinë Demokratike të Kosovës. Ne jemi parti e Kosovës e cila e ka vizion të qartë transformimit politik, ndërmarrësinë në Republikën e Kosovës dhe krijimin e kushteve për të rinjtë e të rejat në mënyrën që të kenë mundësi të barabarta para ligjit dhe shtetit për ta zhvilluar shtetin", ka deklaruar Veseli.



varen prej neve si komunë janë duke u realizuar. Pengesat zakonisht vijnë nëse në ndonjë projekt është i përfshirë niveli qendror. Përndryshe, ato projekte që ne i kemi planifikuar po realizohen. Kemi thënë se do ta bëjmë çerdhen e fëmijëve. Tani ajo është në ndërtim e sipër. Disa projekte madhore që kanë qenë në fshatin Seçisht janë në realizim e sipër. Planifikojmë që gjatë këtij viti në disa fshatra t'i asfaltojmë rrugët. Pastaj kemi edhe projektin e kubzimeve të disa rrugicave në zonën urbane dhe në atë rurale. Sa i përket ndriçimit publik, jemi gati në përfundim edhe në zonën rurale. Ka mbetur për t'u ndriçuar vetëm ndonjë lagje e vogël. Po ashtu, kanë përfunduar procedurat e tenderit për vendosjen e kamerave të sigurisë edhe nëpër fshatra.

Ministri Ismaili paralajmëron masa ndaj punëtorëve të papërgjegjshëm

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se as politika, por as menaxhmenti shëndetësor nuk duhet dhe nuk do të jenë strehë e papunëtorëve dhe të papërgjegjshmëve, të cilët i lënë zyrat dhe dhomat e kontrollit të zbrazëta



EPOKA
ERE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 1 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se janë duke e futur shëndetësinë në binarët e drejtë të një sistemi funksional ku askush nuk do të ndihet i lënë anash. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se në këto nëntë muaj të qeverisjes, MSh-ja ka nisur shumë investime në spitale dhe klinika, të cilat ngadalë po e ndryshojnë gjendjen në sektorin shëndetësor. "Ndalëm avazin e blerjes së barnave me çmime shumëfish më të larta, krijuam shërbimin 24 orësh për mjekimin e sëmundjeve të zemrës në Kardiokirurgji, shtuam sallat e operacioneve, jemi duke blerë pajisje të shumta të cilat kanë munguar me vite të tëra, kemi lëshuar repartin e ri të mjekimit intensiv etj", ka thënë ai.

Ismaili ka treguar se kanë rritur edhe pagesat për kujdestaritë e profesionistëve shëndetësorë

dhe ka bërë me dije se janë duke punuar çdo ditë në Ligjin për paga, që ata më në fund të kenë kushtet që i meritojnë. Ai ka theksuar se tani kanë nisur edhe stabilizimin e furnizimit me barna për institucionet shëndetësore publike, që pacientët të mos kenë nevojë t'i blejnë më ato. "Ngadalë po e fusim shëndetësinë në binarët e drejtë të një sistemi funksional ku askush nuk do të ndihet i lënë anash. Por, krahas shtimit të investimeve, përmirësimit të kushteve për personelin mjekësor dhe pacientët, do të shtohen edhe masat për rritjen e disiplinës në punë, në veçanti ndaj papunëtorëve të cilët i shohin spitalet dhe klinikat tona publike si recepsione referuese", është shprehur ministri Ismaili. Ai ka shtuar se së fundi kanë marrë disa ankesa nga qytetarët, të cilat kanë dërguar edhe fotografi dhe video të ndryshme. "Meqë qytetarët janë epiqendra e shërbimeve tona për të cilët ne jemi duke e bërë gjithë këto punë, edhe këto

ankesa nuk do të kalojnë pa u trajtuar. Prandaj, unë kam marrë vendim që të nisi një seri takimesh me aktorë relevantë për t'i trajtuar të gjitha rastet. Nga këto takime do të dalim me një vendim: Ose do të marrim masa ndaj papërgjegjësive, ose të gjithë ata të cilët e gjejnë veten në atë mes duhet të largo-

hen vetë", ka deklaruar ai. Ministri Ismaili ka thënë se as politika, por as menaxhmenti shëndetësor nuk duhet dhe nuk do të jenë strehë e papunëtorëve dhe të papërgjegjshmëve, të cilët i lënë zyrat dhe dhomat e kontrollit të zbrazëta. "Ne nuk do të mbrojmë askënd që lë pacientët, qytetarët tanë, pa

shërbime cilësore. Dhe, çfarë është më e rëndësishmja, nuk do të lejojmë që disa raste ta nullojnë punën e mijëra punëtorëve shëndetësorë, të cilët me dinjitet dhe vullnet të madh po kontribuojnë në avancimin e reformave që kemi nisur", ka thënë ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili.

Tahiri: Gjyqtarët dhe prokurorët do t'i kenë pagat më të dinjitetshme në rajon



PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka deklaruar se rritja e pagave për gjyqtarë dhe prokurorë të Kosovës do t'ua mundësojë atyre t'i kenë pagat më të dinjitetshme në rajon. Tahiri përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se tash, me rritjen e pagave, pritjet rritje edhe e punës dhe efikasitetit. "Rritja e

pagave për gjyqtarët dhe prokurorët e Republikës së Kosovës duhet të shihet si investim drejt përmbushjes së pritjeve të qytetarëve tanë për një gjyqësor efikas, të pavarur dhe llogaridhënës. Krahas bazës ligjore dhe pavarësisë së plotë për ta mbrojtur ligshmërinë mbi të cilën zhvillohet një shtet bashkëkohor, tani e tutje gjyqtarët dhe prokurorët tanë do t'i

kenë pagat më të dinjitetshme në rajon. Natyrisht kjo rritje edhe pritjet tona për shtim të efikasitetit në angazhimin e tyre për zbatimin e mirëfilltë të ligjit, luftën e pakompromis kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe qasjen në drejtësi kuptimplotë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës", ka thënë Tahiri.

Konstituohet Këshilli Drejtues i AAK-së

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka konstituuar Këshillin e ri Drejtues të dalë nga zgjedhjet e brendshme të partisë më 23 qershor. Për 117 anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka shpërndarë konfirmimin si anëtar i organit më të lartë drejtues të partisë. "Aleanca është e gatshme për të arritur suksese të reja si subjekt politik. Jam i kënaqur me pro-

cesin zgjedhor brenda AAK-së, me garën e zhvilluar dhe zgjedhjen tuaj anëtarë të Këshillit Drejtues të Aleancës përmes garës dhe besimit të marrë me votë nga delegatët", ka thënë Haradinaj para anëtarëve të Këshillit Drejtues të AAK-së. Haradinaj ka ftuar organet e partisë të punojnë e të angazhohen edhe më shumë që Aleanca të jetë partia e parë në Kosovë. "Juve ju bie barra e udhëheqjes së partisë. Nga ky

Këshill do të dalë edhe kryesia e partisë e cila e ka obligim t'i udhëheqë të gjitha strukturat e partisë në çdo cep të Kosovës. Pres nga ju angazhim edhe më të madh, të jemi sa më afër votuesit të Aleancës dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës", ka thënë Haradinaj. Ai ka premtuar bashkëpunim të sigurtë dhe kolegial. "Ju uroj punë të mbarë dhe suksese në përgjegjësitë tuaja në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës", ka thënë Haradinaj.



Njohësit e rrethanave politike dhe të sigurisë kanë folur për procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura

Analistët: Formimi i ushtrisë përmes ndryshimeve kushtetuese, i pamundur



AFP

Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri përmes ndryshimeve kushtetuese tani për tani është i pamundur. Kështu kanë vlerësuar të dielën për gazetën "Epoka e re" analisti politik Behxhet Shala dhe njohësi i çështjeve të sigurisë, Kadri Kastrati. Ata kanë thënë se aktualisht është shumë e vështirë të bindet komuniteti serb për t'i votuar ndryshimet kushtetuese. Sipas tyre, FSK-së mund t'i ndryshohet mandati edhe përmes ligjit, por një gjë e tillë nuk po mbështetet nga ndërkombëtarët

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 1 KORRIK - Njohësi i çështjeve të sigurisë dhe ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, u ka bërë thirrje institucioneve të vendit që sa më shpejt me anë të ligjit t'ia ndryshojnë mandatin FSK-së meqenëse themelimi i Forcave të Armatosura me anë të ndryshimeve kushtetuese po shihet si rrugë e pamundur. "Edhe unë pajtohem se transformimi i FSK-së me anë të ndryshimeve kushtetuese, sikur po dëshirojmë të gjithë tani për tani, është i pamundur. Përfaqësuesit e komunitetit serb për arsye politike, të ndikuar nga Beogradi, nuk do t'i votojnë ndryshimet e nevojshme kushtetuese për formimin e ushtrisë. Prandaj,

Qeveria e Kosovës dhe institucionet e tjera duhet t'i paralajmërojnë partnerët tanë se Kosova do ta ndjekë rrugën ligjore për ndryshimin e mandatit të FSK-së, duke ia dhënë mundësinë që FSK-ja t'i zhvillojë kapacitetet e veta ushtarake dhe të jetë e gatshme brenda një kohe të caktuar t'i kryejë obligimet që i ka në bazë të ligjeve dhe sipas nevojave që ka Kosova në aspektin e sigurisë", ka deklaruar Kastrati për gazetën "Epoka e re".

Ai ka thënë se Kosova është duke humbur shumë me vonesat në formimin e ushtrisë. "Kosova po humbet me këto vonesa, sepse për ta bërë një ushtri operationale duhen rreth 10 vjet kohë. Pra, ushtria nuk mund të bëhet brenda një kohe të shkurtër. Prandaj po them që sa më herët të fillohet të vepro-

het në këtë drejtim është më mirë. Në këtë drejtim Kosova po humbet në aspektin e sigurisë, në aspektin e integritetit në NATO, si dhe në aspektin e integritetit rajonale dhe anëtarësimin në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë", ka thënë Kastrati, duke shtuar se Kosova nuk ka asnjë arsye të vonohet në këtë drejtim. Sipas tij, institucionet e Kosovës këtë vit duhet të marrin vendim për ndryshimin e mandatit të FSK-së.

Edhe analisti politik Behxhet Shala ka thënë se aktualisht është i pamundur transformimi i FSK-së në ushtri përmes ndryshimeve kushtetuese. Ai ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se tani për tani serbët nuk duan të bëhen pjesë e këtyre ndryshimeve për shkak se janë të ndikuar nga Beogradi.

"Pakoja e Ahtisarit ka parashikuar që për interesa të tyre serbët e Kosovës mund të kenë veto dhe mund t'i pengojnë ndryshimet e Kushtetutës. Dhe ata po shihen që në asnjë mënyrë nuk po duan të bëhen pjesë e ndryshimeve kushtetuese për transformimin e FSK-së", është shprehur Shala. Ai ka vlerësuar se është një situatë jo e mirë meqë FSK-ja ka mbetur viktimë e bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë që po zhvillohen në Bruksel. "Është e qartë se transformimi i FSK-së është duke e pritur përfundimin e bisedimeve me Serbinë. Serbia është duke u përpjekur të fitojë sa më tepër dhe në këtë çështje e ka futur edhe transformimin e FSK-së duke e ndërlidhur me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Aktualisht është i pamundur ndryshimi i Kushtetutës për transformimin e FSK-së përderisa nuk është edhe pëlqimi i komunitetit serb. Tash për tash serbët në asnjë mënyrë nuk do ta japin pëlqimin për këtë transformim. Përderisa nuk ka një status të qartë të këtyre bisedimeve atëherë nuk do të ketë mundësi që FSK-ja të transformohet në ushtri. Nuk ka asnjë mundësi që

FSK-ja të transformohet përmes ndryshimeve kushtetuese tani për tani", ka deklaruar Shala, duke shtuar se FSK-së mund t'i ndryshohet mandati edhe përmes ligjit, por një gjë e tillë nuk po mbështetet nga ndërkombëtarët. "Këto premtime që po i bëjnë politikanët për çështjen e transformimit të FSK-së janë për përdorim të brendshëm sepse e dinë edhe vetë se nuk ka mundësi që në këto rrethana të ndryshohet Kushtetuta, kurse ndërkombëtarët e kundërshtojnë transformimin përmes ligjit. Transformimi i FSK-së përmes ligjit po përdoret nga politikanët tanë vetëm si kërcënim, sepse kjo mundësi është përjashtuar krejtësisht nga ndërkombëtarët. Ata thonë se Kosova duhet të ketë ushtri, mirëpo kjo duhet të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese, ndërkohë që nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për t'i bindur serbët që t'i votojnë ndryshimet kushtetuese. Janë dy rrugë për transformimin e FSK-së: e para është përmes ndryshimeve kushtetuese që po e kundërshtojnë serbët, e dyta përmes ligjit, e cila, po ashtu, po kundërshtohet nga ndërkombëtarët", ka theksuar Shala.



Shpenzimet qeveritare shënojnë rritje 12 për qind

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për vlerësimin e tremujorit të parë (TM1), shpenzimet kapitale në muajt janar dhe shkurt të vitit 2018 kanë shënuar rritje prej 9 përqindësh krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërkohë që shpenzimet rrjedhëse të qeverisë janë rritur për 12 për qind

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 KORRIK - Sipas të dhënave më të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në tremujorin e katërt të vitit 2017 shënoi një rritje vjetore prej 3.2 përqindësh. Kontributi kryesor në këtë rritje ka ardhur nga eksportet neto (mallra dhe shërbime) dhe investimet totale, me rreth 1.46 pikë përqindje dhe 1.10 pikë përqindje, respektivisht. Kontributi pozitiv në rritje i eksporteve neto këtë tremujor krahasuar me tremujorin e vitit 2016 është rezultat i rritjes së eksporteve, veçanërisht atyre të shërbimeve.

Ndërsa konsumi privat ka pasur kontribut të lehtë pozitiv në rritjen reale të BPV-së në tremujorin e katërt të 2017-s, me rreth 0.14 pikë përqindje, ndërkohë që ky kontribut në të njëjtën periudhë të vitit paraprak është

luhatur rreth vlerës 3.15 për qind. Ky kontribut pozitiv mbështetet nga zhvillimet pozitive që janë regjistruar në burimet kryesore të financimit të konsumit privat". Sipas këtij raporti, në tremujorin e katërt të 2017-s remitenat, kompensimi i punëtorëve dhe kredia e re për konsum kanë përsheptuar trendin e rritjes së tyre, duke shënuar rritje vjetore prej 10.15 përkatësisht 60 për qind. "Ndërkohë vlera më e ulët e kontributit të konsumit privat në tremujorin e katërt të vitit 2017 ndaj tremujorit të njëjtë të vitit 2016 i atribuohet kryesisht rritjes më të ngadaltë të importeve të mallrave të konsumit. Kontributi pozitiv i investimeve totale u atribuohet kryesisht investimeve private, duke marrë në konsideratë se investimet publike gjatë tremujorit të katërt të 2017-s kanë shënuar rënie prej 9 përqindësh në terma vjetorë", është thënë në

raportin e BQK-së.

Më tej në këtë raport theksohet se, sipas metodës së prodhimit, kontributin më të madh në rritjen e BPV-së reale në tremujorin e katërt të vitit 2017 e kishte industria përpunuese (1.05 pikë përqindje), tregtia me shumicë e pakicë dhe riparimi i automjeteve e motoçikletave (0.95 pikë përqindje) dhe aktivitetet financiare dhe të sigurimit (0.97 pikë përqindje). "Kategoria 'shërbime të tjera' ka pasur kontributin më të madh negativ (2.2 pikë përqindje) në rritjen e BPV-së reale. Për gjithë periudhën janar-shtator 2017, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje reale mesatarisht rreth 3.9 për qind, duke qëndruar lehtësisht poshtë rritjes mesatare të shënuar në vitin 2016 (rreth 4.1 për qind)", thuhet në raport.

Sipas BQK-së, shpenzimet kapitale në muajt janar dhe shkurt të vitit 2018 kanë shënuar rritje prej 9-përqindësh krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërkohë që shpenzimet rrjedhëse të Qeverisë janë rritur për 12 për qind. "Sa i përket ecurisë së konsumit privat në tremujorin e parë të vitit 2018, burimet kryesore të financimit japin sinjale pozitive. Importi i mallrave të konsumit është rritur me 1.7 për qind në terma vjetorë gjatë këtij tremujori. Gjithashtu, remitenat,

kompensimi i punëtorëve dhe kredia e re për konsum kanë ruajtur trendin e rritjes së tyre, duke shënuar rritje vjetore prej 9.27, përkatësisht 52 për qind", thuhet në raportin e BQK-së.

Sipas këtij raporti, treguesit e tërthortë për investimet private ofrojnë sinjale negative në tremujorin e parë të vitit 2018. "Investimet e huaja direkte dhe kreditë e reja për investim kanë shënuar norma rritje të moderuara, rreth 7.9 për qind dhe 29 për qind, respektivisht, krahasuar me tremujorin e vitit paraardhës. Ndërsa importi i mallrave kapitale ka shënuar rënie prej 0.5 përqindësh. Gjithashtu, numri i bizneseve të reja, korrigjuar me numrin e bizneseve të mbyllura, ka regjistruar rënie prej 13 përqindësh", theksohet në raportin e BQK-së.

Sipas projeksioneve të BQK-së, aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2018 do të shënojë një përmirësim të lehtë krahasuar me të dhënat aktuale të vitit 2017, duke u luhatur në një interval prej 4.2 përqindësh në 4.4 për qind. "Ky përmirësim i lehtë i atribuohet stimulit të përforcuar fiskal gjatë vitit 2018, veçanërisht ai i gjeneruar nga shpenzimet kapitale të Qeverisë", është thënë në raportin e BQK-së, kurse remitenat dhe aktiviteti kredid-

hënës edhe gjatë vitit 2018 do të vazhdojnë të jenë burime të qëndrueshme për financimin e aktivitetit ekonomik. "Ambienti i jashtëm do të jetë favorizues për bilancin tregtar, si rezultat i rritjes më të ngadaltë të çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare dhe një rishikim të aktivitetit ekonomik në vendet partnere tregtare të Kosovës. Në tremujorin e katërt të vitit 2017 shkalla e punësimit u rrit lehtësisht në 29.8 për qind krahasuar me vlerën 29.5 për qind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pavarësisht kësaj, norma e papunësisë u luhatur rreth vlerës 30.6 për qind në tremujorin e katërt të vitit 2017, ndërkohë që në tremujorin e fundit të vitit 2016 kjo normë regjistroi një vlerë më të ulët, rreth 28.7 për qind", është thënë në raportin e BQK-së.

Kurse arsyeja pse rritja e shkallës së punësimit nuk është reflektuar në reduktimin e normës së papunësisë, qëndron në rritjen e shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vlerën 42.9 për qind në fund të vitit 2017 krahasuar me shkallën prej 41.3 përqindësh në fund të vitit 2016. "Tendencat e treguesve kryesorë të punës të shënuar gjatë tremujorit të katërt janë të njëjta me zhvillimet e regjistruara gjatë gjithë vitit 2017", thuhet në raportin e BQK-së.

Shtesat për fëmijë pritet të jenë nga 10 deri në 40 euro në muaj

PRISHTINË, 1 KORRIK - Kosova nuk zbaton asnjë skemë sociale apo përfitime për fëmijët. Deri më tani shtesat për fëmijët zakonisht ishin vetëm premtime zgjedhore dhe me përmbylljen e proceseve zgjedhore, gjithçka përfundonte aty. Së fundmi, një grup i deputetëve po kërkon të aplikohen shtesat për të gjithë fëmijët e Republikës së Kosovës si një nevojë urgjente edhe për zbutjen e varfërisë të familjet në nevojë. Në këto propozime fillestare thuhet se në këto skema do të përfshiheshin fëmijët nga 0 - 16 vjeç.

Sipas organizatave joqeveritare që merren me të drejtat e fëmijëve, thuhet se në Kosovë rreth 33 për qind e fëmijëve jetojnë në varfëri. Po këto të dhëna thonë se mbi 10 për qind e fëmijëve janë të përfshirë në punë, kurse rreth 7 për qind punojnë punë të rënda apo të rrezikshme.

Nismat për aplikimin e shtesave për fëmijët mirëpritën sidomos nga prindërit.

Besa Gashi nga Prishtina është nënë e dy fëmijëve. Besa, e cila nuk punon, e mirëpret iniciativën, duke thënë se, pavarësisht prej shumës sa do të ishte, ajo do të ndikonte në mirëqenien e familjes dhe fëmijëve të saj. "Do të ishte shumë mirë që Qeveria të japë shtesa për fëmijët, qoftë edhe një shumë solide. Unë e mirëpres dhe besoj se është iniciativë e duhur. Në Kosovë pagat janë të vogla. Këto shtesa do të ndihmonin", ka thënë Besa Gashi.

Edhe pensionisti Gani Hasani e vlerëson si propozim të qëlluar çdo nismë për aplikimin e skemave të shtesave për fëmijët. "Do të jetë një lehtësim për familjet, që me ato mjete të genden disi në jetën e shtrenjtë që



ka kapluar shumicën dërrmuese të familjeve. Unë mendoj se ky propozim është i qëlluar, i menduar mirë, i nevojshëm. Shpresoj se do të realizohet", ka thënë Hasani.

Organizatave joqeveritare që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve kanë kërkuar disa herë nga ekzekutivi të rishikohet skema sociale dhe në kuadër të saj, të vendosen edhe shtesat për fëmijë.

Klevis Vaqari nga Koalicioni i Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve, KOMF, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se e përkrahin çdo mbështetje financiare për fëmijët. "Secila iniciativë, propozim apo veprim i ndërmarrë që nënkup-

ton investim më të madh të fëmijët, jo vetëm që është e mirëseardhur, por është një ndër shtyllat kyçe të avokimit tonë drejt politikëbërësve dhe vendimmarrësve në nivel qendror, po ashtu edhe në nivel lokal", ka theksuar ai.

Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Donika Kadaj-Bujupi, të mërkurën ka dorëzuar një mocion përmbajtjesor në Kuvend për shtesat e fëmijëve të Republikës së Kosovës.

Në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" ajo shpreson se këtë nismë do ta përkrahin të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës në mënyrë që me buxhetin e vitit të ardhshëm të

fillojë të zbatohet. Ajo ka thënë se është llogaritur se nga kjo nismë do të përfitojnë rreth 500 mijë fëmijë, nga mosha 0 deri në 16 vjeç, me nga 10 deri në 40 euro në muaj varësisht numrit të fëmijëve. Sipas një llogarie, Kadaj-Bujupi shprehet se vlera e shtesave të fëmijëve mund të arrijë në tre për qind të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës. "Gjendemi në një periudhë kur vazhdojmë të kemi probleme të mëdha me papunësinë dhe vazhdojmë të kemi fëmijë të cilët jetojnë në kushte të vështira dhe të varfra. Kjo do të jetë një nismë e vogël, por me qëllim që vit pas viti të rriten këto shtesa dhe fëmijët të kenë një stimulim të prekshëm", ka thënë Kadaj-Bujupi.

Kadaj-Bujupi shpreh shqetësimin se numri i lindjeve në Kosovë po bie vit pas viti dhe shtesat e fëmijëve, thotë ajo, do të jenë stimulim që mos të zvogëlohet edhe më tutje numri i lindjeve. Por, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale tregojnë se deri më tani kjo temë nuk është diskutuar, pasi nuk ka pasur ndonjë dokument zyrtar.

Përfitimet materiale për fëmijët ka qenë premtimi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, sikurse i partive të tjera pjesëmarrëse në zgjedhjet e fundit. Kurse ish-kryetari i Partisë Demokratike, tashmë president i Kosovës, Hashim Thaçi, kishte premtuar 300 euro për çdo fëmijë të sapolindur, premtim ky që nuk është realizuar asnjëherë.

MAPL-ja vlerësohet për llogaridhënie dhe menaxhim të financave publike

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se është vlerësuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për shkallën e lartë të llogaridhënies dhe menaxhimit e financave publike. "Zyra Kombëtare e Auditimit ka publikuar raportin vjetor të auditimit të përgatitur nga kompania ndërkombëtare audituese 'Deloitte', ku MAPL-ja vlerësohet për shkallën e lartë të kontrollit dhe llogaridhënies në procesin e menaxhimit financiar të financave publike si dhe adresimin e rekomandimeve",



është theksuar në komunikatë. Sipas kësaj komunikate, raporti i auditimit e vlerëson MAPL-në si

institucion që ka vendosur kontrole të shëndosha në raport me detyrimet e saj, ku menaxhimi

dhe kontrolli financiar kanë dëshmuar një proces të mirë shqyrtimi dhe një siguri të legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. "MAPL për vitin 2017 nuk ka marrë asnjë rekomandim në fushat si vijon: Pasqyrat financiare vjetore; Pagat dhe mëditjet; Mallrat dhe shërbimet; Shërbimet komunale; Investimet kapitale; Menaxhimi i resurseve njerëzore; Subvencionet dhe transferimet; Obligimet e papaguara; Sistemi i auditimit të brendshëm", është thënë më tutje në komunikatë. MAPL mbetet e përkushtuar në adresimin e të gjitha të gjeturave

dhe zbatimin e të gjitha rekomandimeve. "Raporti vjetori i auditimit për MAPL-në, po ashtu, ka vlerësuar progresin e arritur për implementimin e rekomandimeve të auditimit. Nga një vlerësim për tre vjet: 2015, 2016 dhe 2017, raporti gjen se është bërë progres në implementimin e të gjitha rekomandimeve. Nga 10 rekomandime në total të dhënë në vitin 2015, në vitin 2017 janë zbatuar plotësisht gjashtë prej tyre dhe 4 janë adresuar dhe janë në proces të zbatimit", është theksuar në komunikatën e MAPL-së.

Sot i jepet lamtumira e fundit veprimtarit të çështjes kombëtare, Bajrush Behrami

Ndërron jetë atdhetari Bajrush Behrami

Ka ndërruar jetë në moshën 61-vjeçare Bajrush Behrami, veprimtar i shquar i çështjes kombëtare shqiptare. Ai ka qenë një prej organizatorëve kryesor të demonstratave të vitit 1981 dhe kishte vuajtur 9 vjet burgim. Vdekja e hershme e Behramit, përpos familjarëve, ka lënë të pikëlluar miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij. Varrimi i Behramit do të bëhet sot (e hënë) në orën 17:00 në varrezat e qytetit të Besianës



bëtare, Bajrush Behrami. Gashi ka theksuar se kujtimi dhe kontributi i Behramit për atdheun do të jetë i përhershëm. "Me pikëllim të thellë mora lajmin për vdekjen e veprimtarit të madh të çështjes kombëtare, Bajrush Behramit, ish i burgosur politik, nëntë vjet në burgjet serbe, veprimtar i paepur për çështje kombëtare. Vdekjen e pate të parakohshme miku im, por kontributi yt për atdheun tonë e kujtimi ynë për ju do të mbeten të përjetshëm. Prehu në paqe, Bajrush! I lehtë të qoftë dheu i Kosovës", ka shkruar Gashi në llogarinë vet në "Facebook".

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Veprimtari i çështjes kombëtare shqiptare, Bajrush Behrami, ka ndërruar jetë të dielën në moshën 61-vjeçare. Behrami ka qenë ish i burgosur politik, i cili ka vuajtur nëntë vjet burgim. Po ashtu, ai ka qenë veteran i UÇK-së, publicist dhe piktor. Për nder të kontributit të tij, sot (e hënë) do të mbahet një akademi përkujtimore, ndërsa varrimi do të bëhet në orën 17:00 në varrezat e qytetit të Besianës.

Përpos familjarëve, vdekja e tij e hershme ka lënë të pikëlluar miqtë dhe bashkëpunëtorët. Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili

ka punuar me Behramin në Zyrën e UÇK-së në Prishtinë, ka thënë se me pikëllim e ka marrë lajmin për vdekjen e tij. "Me pikëllim të thellë mora lajmin që ka vdekur Bajrush Behrami. Ai ka qenë i burgosur politik për nëntë vjet, veprimtar i paepur për çështje kombëtare e për drejtësi shoqërore. Në vitet 1998 dhe 1999 me Bajrushin kemi punuar bashkë në zyrën e UÇK-së në Prishtinë të udhëhequr nga përfaqësuesi i përgjithshëm politik i UÇK-së, z. Adem Demaçi", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook". Kurti ka thënë se për Bajrush Behramin ka kujtimet më të mira dhe përvojat më të vlef-

shme nga ato kohë të vështira. "Vdekja e tij më dhemb. Një botë e tërë e vuajtjeve dhe mirësisë në një njeri të vetëm më duket se na iku. Vdekjen e pati të parakohshme, por kontributi i tij për ne e kujtimi ynë për të

mbeten të përjetshëm", ka shkruar Kurti.

Edhe ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Latif Gashi-Lata, ka thënë se me pikëllim e ka marrë lajmin për ndarjen nga jeta të veprimtarit të çështjes kom-

Nga vdekja e hershme e Bajrush Behramit është prekur anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Rustem Mustafa - Remi. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Bajrush Behrami ishte patriot, i qetë, i urtë, artist dhe i dashur. "Miku im, patriot, i qetë, i urtë, artist, i dashur, i këndshëm me humor, të bënte për vete dhe aktiv në kohët e vështira. Pusho i qetë, Bajrush Behrami!", ka shkruar Mustafa.

Haskuka takohet me Vrkicin, flasin për bashkëpunimin e ndërsjellë

PRIZREN, 1 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, është prituri në takim nga homologu i tij nga Komuna e Osijekut, Ivica Vrkiq, me të cilin ka biseduar për aplikim për projekte të përbashkëta në Bashkimin Evropian. "Në qytetin e binjakëzuar të Osijekut, në Kroaci, u takuam me kryetarin e komunës, Ivica Vrkiq, me të cilin diskutuam për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe atij të Osijekut. Ndër të tjera, biseduam për aplikim të përbashkët për të përfutur nga fondet e ndryshme të Bashkimit Evropian, ku Komuna e Osijekut ka pasur sukses të jashtëzakonshëm në vitet e kaluara", ka thënë Haskuka. Ai ka bërë me dije se me Vrkicin ka biseduar edhe për mundësinë e bashkëpunimit në fushën e trashëgimisë kulturore. "Pos kësaj, shikua edhe mundësitë e bashkëpunimit në fushën e trashëgimisë kulturore dhe zgjidhjen e problemeve të



ndryshme edukative, ku do të mund t'i shkëmbejm përvojat me qytetin e Osijekut. Në fund të takimit u pajtuam ta finalizojmë një listë të projekteve, me të cilën

do të aplikojmë për fondet e Bashkimit Evropian, së bashku edhe me qytetet e tjera të binjakëzuara", është shprehur Haskuka.

Sot nis punën shkolla verore 'Bleta'

SHTIME, 1 KORRIK (ER) - Komuna e Shtimes ka njoftuar se sot (e hënë) në objektin e Shkollës së Mesme Profesionale do ta nisë punën shkolla verore "Bleta" e cila do të organizohet nga DKA-ja për të katërtën herë me radhë. Komuna e Shtimes ka falënderuar anëtarët e rrjetit "Pro net" për punën vullnetare për përgatitjen e nevojshme për fillimin e kësaj shkolle. Shkolla verore "Bleta" do të zgjasë dhjetë ditë dhe aty do

të zhvillohen kurset në lëndët: gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi angleze, teknologji informative, art figurativ dhe edukatë muzikore.

Pjesëmarrës në këtë shkollë do të jenë 105 nxënës të klasave VI deri VIII të shkollave të Komunës së Shtimes, të cilët paraprakisht janë përzgjedhur nga drejtorët e shkollave në bashkëpunim me pedagogët. Edhe këtë vit stafi do të jetë i kualifikuar dhe i përgatitur profesionalisht.



I PAPRANUESHËM ËSHTË DIALOGU QË U SHËRBEN VETËM INTERESAVE TË SERBISË



Ismajl KURTESHI

Kuvendi i Kosovës duhet t'i fillojë procedurat e shkarkimit të presidentit, i cili, në prag të fillimit të dialogut përfundimtar me Serbinë, deklaroi se nuk ka nevojë për vija të kuqe në këtë dialog. Në platformën e Qeverisë të marsit 2011 thuhej: Sovraniteti dhe integriteti territorial është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm. Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovraane e institucioneve shtetërore. Plani i Ahtisarit për rregullimin e të drejtave dhe garancive për komunitetet është i panegociueshëm.

Këto tri çështje ishin vija të kuqe për të cilat askush nuk kishte të drejtë të dialogojë. Në prag të fillimit të dialogut përmbyllës, në vitin 2018, presidenti i Kosovës deklaroi se në këtë dialog nuk nevojiten vija të kuqe. Ky njeri nuk mund ta përfaqësojë Kosovën, prandaj Kuvendi duhet ta fillojë procedurën e shkarkimit të tij.

Në qoftë se analizohen me kujdes temat për të cilat Kosova ka dialogu me Serbinë, marrëveshjet e arritura dhe përfitimet nga ky dialog del se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë që është zhvilluar nga viti 2011 u ka shërbyer ekskluzivisht interesave të Serbisë.

Edhe nga dialogu i ardhshëm në mes të Kosovës dhe Serbisë, që po pretendohet të jetë përmbyllëse, ka shumë gjasa të përfitojë Serbia në dy drejtime. Të integrohet në BE dhe ta legjitimojë ndërhyrjen në organizimin e

brendshëm të Kosovës. Kurse Kosova si përherë po vazhdon të marrë pjesë në dialog pa platformë, pa konsensus politik e shoqëror dhe krejt e papërgatitur.

I. Më 10 mars 2011 Kuvendi i Kosovës pati miratuar Rezolutën përmes së cilës mbështeti "dialogun midis dy shteteve të pavarura dhe sovraane, Kosovës dhe Serbisë, për çështje praktike, në interes të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet..."

1. Edhe pse Kuvendi i Kosovës mbështeti dialogun në mes të dy shteteve sovraane, ende nuk është e definuar kush me kënd po negocion? Shteti i pavarur i Kosovës me Serbinë, siç po deklaroi pala e Kosovës, apo Serbia me Krahinën e saj jugore, si është e definuar në Kushtetutën e Serbisë.

Pa përcaktimin përfundimtar të kësaj çështjeje s'kanë si të definohen çështjet që janë objekt i marrëveshjeve, sepse marrëveshjet determinohen nga statusi i palëve në dialog.

2. Rezoluta e vitit 2011 e miratuar në Kuvend mbështeste dialogun në interes të përmirësimit të jetës së qytetarëve... por gjatë dialogut është biseduar vetëm për serbët e Kosovës dhe asnjëherë nuk është diskutuar për përmirësimin e jetës së qytetarëve shqiptarë, që jetojnë në trojet e tyre, në Luginën e Preshevës.

3. Kuvendi i Kosovës, përmes Rezolutës, i obligonte përfaqësuesit e Kosovës që përmes këtij dialogu të kontribuojnë në avancimin e agjendës evropiane për Kosovën. Derisa Serbia falë dialogut ka avancuar shumë në këtë drejtim, Kosova ka mbetur vendi i vetëm i izoluar në Evropë edhe për shkak të angazhimit të hapur të Serbisë për mospranimin e Kosovës në institucione të ndryshme ndërkombëtare.

4. Kuvendi përmes Rezolutës së

lartpërmendur pati obliguar Qeverinë e Kosovës t'ia paraqiste Kuvendit dokumentin themelor mbi bazën e të cilit do të zhvillohet dialogu.

5. Në platformën e Qeverisë të marsit 2011 vlen të veçohen këto elemente: Sovraniteti dhe integriteti territorial është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm. Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovraane e institucioneve shtetërore. Plani i Ahtisarit për rregullimin e të drejtave dhe garancive për komunitetet është i panegociueshëm. Asnjëra nga këto elemente të Platformës së Qeverisë për dialog nuk u respektuan.

II. Duke pasur parasysh se nga dialogu teknik u kalua në dialog politik, Kuvendi i Kosovës më 18 tetor 2012 e autorizoi Qeverinë ta udhëheqë dialogun politik, me pjesëmarrjen e komisioneve relevante parlamentare. Po ashtu, u kërkua nga Qeveria të raportojë rregullisht mbi procesin e dialogut.

1. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është karakterizuar me mungesë të konsultimeve, mungesë të platformës shtetërore, mungesë të përgatitjeve për dialog dhe mungesë të llogaridhënies nga përfaqësuesit e Kosovës.

Kurse Komisionet Parlamentare nuk u bënë pjesë e delegacionit që dialogonte.

Dokumentet, si ai i 15 janarit 2015 të publikuar nga Edita Tahiri, ku bëhet fjalë për shtyllat e procesit të dialogut, vijat e kuqe dhe transparencën, përveç të tjerash, thuhet se parim themelor është mosndërhyrja në sovranitetin e njëri-tjetrit, zhbërja e struktura paralele, zgjidhja e çështjeve të reparacionit të luftës dhe suksesionit.

Koha ka dëshmuar se asgjë nga ajo që është thënë në këtë dokument nuk është realizuar.

2. Përkundër faktit se janë nën-

shkruar mbi 20 marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë, Serbia respekton vetëm marrëveshjet për vulat doganore, mbledhjen e të hyrave doganore për veriun dhe njohjen e polisave të automjeteve (pra vetëm ato marrëveshje që i duhen Serbisë).

3. Vlen të përmendet se tekstet e marrëveshjeve i karakterizojnë dykuptimësia e tyre që pastaj u mundëson palëve t'i interpretojnë marrëveshjet sipas interesave të tyre.

4. Serbët e Kosovës as nuk janë integruar, as nuk e njohin shtetin e Kosovës siç ndodh edhe me deputetët, ministrat dhe zyrtarët e tjerë serbë.

Serbia po e minon shtetësinë e Kosovës me të gjitha mjetet.

Kosova është vend i vetëm në Evropë pa një të ardhme të qartë të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

III. Faza e re e dialogut Kosovë - Serbi nuk ndryshon nga dialogu i mëhershëm në mes të dy vendeve.

Serbia nuk ka lëvizur nga qëndrimet e saj hegemoniste karshi Kosovës.

Pala kosovare i ka filluar bisedimet, si përherë, pa një konsultim të gjerë politik apo shoqëror, pa platformë shtetërore, pa transparencë, pa i bërë të qarta synimet që do t'i arrijë në këtë proces.

Presidenti i vendit ka shkruar në Bruksel, si përherë, pa miratimin e Kuvendit dhe pa marrëveshje me partitë politike, pa platformë të bisedimeve, i papërgatitur dhe jotransparent. Ky president që deklaroi se nuk duhet të ketë vija të kuqe në dialog me Serbinë nuk mund ta përfaqësojë Kosovën. Presidenti që bisedimet i quan të vështira dhe paralajmëron koncesione të reja nuk ka as vullnet, as dije dhe as guxim t'i mbrojë interesat e këtij vendi.

IV. Në lidhje me Platformën e Qeverisë së Kosovës për dialogun

me Serbinë, Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme më 7 maj 2018 i rekomandoi Kuvendit të Kosovës të mos e miratojë Platformën Shtetërore për finalizimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënies në mes të dy vendeve, në formën ekzistuese. Komisioni konstatoi se Kosova duhet ta ketë platformën shtetërore e cila do të jetë rezultat i konsensusit të gjerë ndërmjet partive parlamentare. Komisioni, po ashtu, rekomandoi që Kuvendi të organizojë një debat parlamentar nga i cili do të dalin rekomandimet për ndërtimin e platformës konsensuale të shtetit të Kosovës. Rekomandimet e Komisionit nuk u përfillën. Kuvendi, i cili, duhet ta ketë rolin mbikëqyrës, mbi të gjitha, procesin e dialogut, po injorohet.

Në fazën e re të dialogut duhet ta merrte parasysh edhe vlerësimin gjithëpërfshirës të dialogut të gjertanishëm dhe marrëveshjet e arritura. Rezultatet e këtij vlerësimi duhet të reflektojnë në fazën e re të dialogut që po pretendohet të jetë ligjrisht obligativ dhe përfundimtar.

Kosova ka përjetuar marrëveshje obligative, të cilat janë quajtur edhe përfundimtare, si ajo e vitit 1912, kur Kosova është ndarë me forcë nga trangu etnik dhe është robtuar nga Serbia. Në vitin 1945, kur pas Luftës së Dytë Botërore, Kosovës edhe një herë i imponohet vazhdimi i robërisë nën thundrën serbe, edhe në vitin 1989 kur Kosovës i mohohen të drejtat e garantuara me Kushtetutën e vitit 1974.

Marrëveshja përfundimtare dhe afatgjatë do të arrihet vetëm kur ajo është e drejtë, parimore dhe pranueshme për qytetarët e Kosovës.

Marrëveshjet e fshehta të Presidentit të vetautorizuar nuk janë të Kosovës, por ato vetëm sa do ta komplikojnë situatën edhe ashtu të komplikuar në Ballkan.

Ushtria ruse rrëzon dronë në afërsi të bazës ajrore në Siri

Moskë, 1 korrik - Ushtria ruse ka njoftuar se ka rrëzuar dronë të paidentifikuar pranë bazës ajrore Hmeimim në perëndim të

Sirisë. Agjencitë e lajmeve ruse kanë cituar zëdhënësin e kësaj baze të ketë thënë se të gjithë dronët janë shkatërruar nga

armët anti-ajrore. "Baza nuk është dëmtuar dhe asnjë pjesëtar i stafit nuk ka pësuar lëndime gjatë këtij incidenti, i cili ka

ndodhur në mbrëmjen e 30 qershorit", ka thënë zëdhënësi i bazës ajrore Hmeimim në perëndim të Sirisë.



Austria merr presidencën e radhës në BE, vëmendja tek emigracioni

VJENË, 1 KORRIK - Austria ka marrë presidencën e Bashkimit Evropian (BE) dhe me këtë për herë të parë e ka kryesinë një koalicion populistësh të djathtë në BE. Debati për një politikë të përbashkët emigrimi në BE nuk ka marrë fund. Madje në Gjermani Qeveria ndodhet para një krize, sepse shtetet e Vishegradit vazhdojnë kursin e konfrontimit me BE-në, kurse Italia ka mbyllur portet për anijet me refugjatët e shpëtuar në det. Në samitin e BE-së u arrit me mundim një ujdj që të mbrohen më mirë kufijtë e

jashtëm të BE-së. Çështja se si do të shpërndahen migrantët mbeti pa përgjigje në samit. Pikërisht në këtë kohë, Austria merr presidencën e radhës në BE. Një vend që në çështjen e migracionit nuk ka treguar shumë gatishmëri për kompromis. Kancelari i partisë konservatore OVP, Sebastian Kurz, Qeverisë në Vjenë bashkë me partinë populiste, armiqësore ndaj të huajve FPÖ, beson se njerëzit kanë të drejtë që janë ngopur duke dëgjuar gjithmonë të flitet për

migrimin në nivel evropian dhe të mos ndodhë faktikisht asgjë. Presidencën austriake gjashtëmujore zhvillohet nën moton: "Një Evropë që mbron". Kreu i Qeverisë austriake kërkon me këtë moto ta reduktojë emigrimin në të gjitha itineraret. Vendimi i fundit i BE-së për të ndërtuar kampe në Afrikën e Veriut për emigrantët e shpëtuar në det, është për kreun e Qeverisë austriake drejtimi i duhur. Bullgaria së fundi e kryesonte presidencën e Bashkimit Evropian.



Mijëra persona protestuan në ShBA në mbështetje të imigrantëve



WASHINGTON, 1 KORRIK - Mijëra persona kanë protestuar në kryeqytetin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe në qytete të tjera kundër politikave të migrimit të presidentit, Donald Trump, përfshirë edhe politikën për ndarjen e familjeve. Në sheshin që gjendet përball Shtëpisë së Bardhë, protestuesit brohoritën "Turp, turp". Disa mbanin në duar pankarta ku shkruhej "Ku janë fëmijët" dhe "Ne jemi Amerika". Administrata Trump ka zbatuar politikën "zero tolerancë", që bën

thirrje për ndalimin e migrantëve të cilët hyjnë ilegalisht në Shtetet e Bashkuara. Por, kjo politikë ka rezultuar në ndarjen e prindërve nga fëmijët e tyre. Trump më vonë ka tërhequr politikën e ndarjes, teksa Kongresi po tenton ta kalojë reformën për migrantët. Ndalimi i hyrjeve ilegale në ShBA ishte temë qendrore e fushatës presidenciale të Trumpit. Presidenti Trump ka mbrojtur politikën e tij, duke thënë se ai po tenton t'i zbatojë ligjet amerikane, duke tërhequr paralele mes krimeve të dhunshme dhe migrimit.

Kryeministri i Japonisë kërkon të arrihet një marrëveshje për tregti të lirë

TOKIO, 1 KORRIK - Kryeministri i Japonisë, Shinzo Abe, u ka bërë thirrje liderëve të rajonit të arrijnë marrëveshje që do të mundësonin tregti të lirë, me qëllim që të mbrohen nga politikat proteksioniste të presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump. Japonia së bashku me Singaporen kryeson takimin e Partneritetit Ekonomik Rajonal (RCEP), që nisi të dielën në Tokio. Shtetet që bëjnë pjesë në këtë partneritet përbëjnë rreth



30 për qind të ekonomisë botërore dhe tregtisë globale.

"Derisa ballafaqohemi me shqetësimet lidhur me rritjen e proteksionizmit në botë, të gjithë ne në Azi duhet të bashkohemi dhe e ardhmja jonë varet se a mund ta vazhdojmë të ngremë parimin tonë kryesor të tregtisë së lirë dhe të ndershme. Le të jemi ne ata që arrijmë të krijojmë një treg të lirë, të drejtë dhe me rregulla në këtë rajon", ka thënë Abe. Japonia, po ashtu, ka shprehur shqetësimin për ndikimin e Kinës në rajon.

Qytetarët në Austri protestojnë kundër orarit 12 orësh të punës

VJENË, 1 KORRIK - Vjena është përballur në këtë fundjavë me protesta, pasi qindra dhe mijëra



persona kanë dalë nëpër rrugë ta kundërshtojnë orarin e ri të punës, që Qeveria ka parashikuar ta çojë në 12 orë në ditë. Pavarësisht prej fillimit të pushimeve verore, Bashkimi i Sindikatave Austriake ka arritur të mobilizojë një numër të madh njerëzish, që mendohet të ketë qenë rreth 100 mijë. "Ne do të

rezistojmë me të gjitha mjetet që janë në dispozicion për ne", ka thënë presidenti i Sindikatës Wolfgang Katzian në demonstratën që është zhvilluar në Vjenë.

Ai i bëri thirrje Qeverisë së kancelarit Sebastian Kurz t'u kërkojë qytetarëve një referendum në lidhje me ditën 12 orësh të punës. Sa i takon parlamentit, ky organ legjislativ dëshiron ta vendosë rregulloren e re të orëve të punës këtë të enjte.

Vriten dy ushtarë francezë në Mali

GAO, 1 KORRIK - Dy ushtarë francezë janë vrarë në Mali dhe dhjetëra të tjerë janë plagosur, përfshirë trupa franceze, nga një sulm me

makinë bombë në qytetin Gao, ka konfirmuar Ministria e Brendshme e Malit. "Konfirmojmë se një makinë bombë ka sulmuar një patrullë

të përbashkët të ushtrisë", ka thënë për "Reuters" zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme të Malit, Boubacar Diallo. "Deri më tani e dimë se dy ushtarë

francezë janë vrarë dhe dhjetëra të tjerë janë plagosur. Në mesin e të plagosurve janë edhe tetë ushtarë francezë", ka thënë ai.



NJË ZË ARBËROR VJEN NGA SKANDINAVIA



Imri Trena

Berat LUZHA

Më 2 korrik u bënë 17 vjet qyshkur filloi emetimet e valëve në etër radioja e mërgimtarëve nga Norvegjia, radio "Zëri i Arbërit". Një grup i vogël bashkatdhetarësh në qytetin AS, rreth 25 km larg kryeqytetit Oslo, në krye me Imri Trenën, vendosën ta hapin radion e parë në gjuhën shqipe në Norvegji, fillimisht në kuadër dhe në valët e radios në gjuhën norvegjeze "Follo", deri në vitin 2013, e më vonë, pas mbylljes së saj, si radio e pavarur.

Në valët tokësore të radios publike norvegjeze "Follo", radioja "Zëri i Arbërit" emetoi program pesë orë dy herë në javë, për të filluar programin tërëditor dy herë në javë që nga Dita e Pavarësisë, 17 shkurti 2008. Që nga viti 2013, pas mbylljes së radios norvegjeze, radioja shqipe e zgjeroi programin si program tërëditor dhe të përditshëm, tashmë të emetuar vetëm në internet.

Duhet theksuar se radio "Zëri i Arbërit" ka krijuar një audiencë dhe bashkëpunëtorë, jo vetëm nga mërgimtarët në Skandinavi, por edhe më gjerë, në tërë botën. Emisionet e saj përcillen me interesim jo vetëm nga mërgimtarët tanë anembanë botës, por edhe nga dëgjuesit e shumtë në trojet shqiptare.


Emisionet e radios "Zëri i Arbërit" kryesisht u kushtohen jetës dhe veprimtarisë së mërgimtarëve shqiptarë në botë, por pa lënë anash as emisionet tjera për fëmijë, për kulturë, për art e letërsi, për trashëgiminë gojore të popullit tonë Udhëheqësi i kësaj radioje, Imri Trena, tregon për vështirësitë për mbajtjen e një radioje të tillë, por është vullneti i tij që e bën të mos ndalet asnjëherë për të kontribuar sadopak për përmirësimin e jetës së rëndë të mërgimtarëve

tanë. Qëllimi i parë dhe i fundit i tij është të kontribuojë që mërgimtarët, veçanërisht fëmijët dhe rinia, të mbahen në kontakt të vazhdueshëm me gjuhën, me këngën dhe përgjithësisht me kulturën shqipe, në mënyrë që ata t'i rezistojnë asimilimit kombëtar.

Të mbahet një radio e tillë është njëkohësisht privilegj dhe sakrificë. Sakrificë sepse për mbajtjen e radios duhet kontribuar edhe nga bugjeti familjarë, - thotë kryeredaktori Imri Trena. "Zëri i Arbërit" ka një fond të pasur me material arkivor, veçanërisht me këngë shqipe. Në emisionet e saj nuk zë vend muzika tallava dhe kundërvlerat në art e kulturë, si ngjet me shumë medie elektronike shqipe në vend dhe në emigrim.

Kryeredaktori Trena tregon edhe për një bashkëpunim të mirë që ka radio e tij me Radio Tiranën, me Radio Prishtinën dhe me disa radio të tjera lokale në mërgatë. Bashkëpunëtorët e saj tashmë mbulojnë shumë vende të botës, duke përcjellë veprimtaritë e mërgimtarëve gjithandej.

Zëri shqip i "Zërit të Arbërit", që vjen nga Norvegjia e largët, qoftë edhe në internet, është një zë i artikuluar drejt, një zë meritore, që meriton respekt dhe lëvdatë. Përgëzime për punën e palodhur dhe sukseset e duhura! Urime 17-vjetorin e veprimtarisë, Zëri i Arbërit!



Nga:
Magbule
KELMENDI

Njerëz apo hiena

Rrugë të mbushura ngjyra-ngjyra
nga një pamje vezulluese
a janë yje apo ar nga një pamje në shikim të parë,
E quajnë veten menaxherë, eprorë edhe liderë
Luksin vetes çdo ditë ia shtojnë, a thua në këtë Kosovë jetojnë
Në dritë të diellit si engjëjt duken, në errësira gjak kërkojnë
A janë hiena a janë njerëz, shumë enigma po mbretërojnë
Ecin rrugës si zotërinj, pretendojnë të jenë njeri
Maskarenj dhe asgjë tjetër.

Në varreza Kosovën tretën,
Rriten krimet në përgjithësi, e shkatërruan anekënd
Vallë sa i ngjajnë asaj Serbie, a thua vallë janë hijet e tyre
Dalëngadalë tretën jetën, thyen shpresat dhe të vërtetën.

Sa shpresuam iku Serbia dhe Kosova do ta lulëzojë jetën
Po çka tash o të mjerë, çka të presim se do të bëhet mirë
Kush na sjellë stabilitet, punësim dhe jetë të qetë
Kush o trima që quani veten, kur nuk latë as dëshirë për jetën
Prapë rinia në rrugë të botës, ata tretën për bukë të gojës,
Të jetojmë si popull i shkretë si shërbëtorë dhe si të mjerë
A janë njerëz apo hiena, nuk arrij dot të kuptoj
Gjak njeriu ata pinë, jetë të shumta ata nxijnë.

Ata krijuan klanet e veta, me vota tona po kryejnë vepra
Halla, teze, akraba, ua kanë bërë jetën si pasha
Kur vjen koha t'i votojmë, bëhen dhelpër e zvarranikë
Por të nesërmen me s'të njehë, tash thotë për të gjitha kemi kohë
Tash mandatin thotë e kam gjatë, hiçmu sysh more i ngratë
Si s'u mbushët mend me vite, por gjithë votën ti ma qite.

Kam të afërm dhe dashnore, për punësime mos më lodhë
Mos më trokit as në derë, kam sigurimin në nivel
Kam vetura të blinduara, nuk kam kohë për shtresa të ulëta
Ecin në tokë si figura njeriu, por në shpirt si ariu
Si hiena në shkretëtirë që nuk ngopën gjak t'u pirë
Veç kërkojnë ndonjë viktimitë që qëllimet t'i arrijnë
Janë drejtorë, menaxherë, avokatë dhe e udhëheqës
dhe kjo është tash Kosova, fajdexhi e mafiozë.

S'ka moral e as njerëzi, çmohet ai që di ma zi
Ai që di me ta marrë dhe jetën, se dashnoret kërkojnë drekën
Kërkojnë luks e udhëtime, kush ka kohë për jetimë,
Kush ka kohë për fëmijët e ushtarit, që dhanë jetën e dhanë mallin
Shkon ia ngritë një lapidar, kur vjen koha vota me marrë
Për më shumë s'lejon agjenda se dashnoret kanë planet e veta
S'kanë nevojë për këshilltarë, as ekspertë afër me marrë
Ata dinë se çka ju duhet, veç karrigia si të ruhet
Veç mandati si të zgjatet, dhe serbin e bën dhëndër
A janë hiena a njeri, tash vlerësimin jepe ti!

Autori kroat i kënaqur që ndodhet për vizitë në Kosovë

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Zëvendësministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Burbuqe Bakija-Deva, ka takuar dramaturgun kroat me famë botërore, Miro Gavran, bashkëshorten e tij Mladena dhe regjisorin Marigona Bekteshi-Ferati. Zëvendësministria i ka shprehur mirëseardhje dhe gatishmërinë e MKRS-së për ta përkrahur autorin

dhe regjisorin në bashkëpunimet e tyre në të ardhmen. "Ne si ministri jemi të gatshëm të ndërmarim hapa konkretë që t'i përkrahim aktivitetet të cilat sjellin tek qytetarët tanë autorë e regjisorë të njohur", ka thënë zëvendësministria Burbuqe Bakija-Deva. Ndërkaq autori kroat dhe bashkëshortja e tij u shprehën se

ndihen të kënaqur që ndodhen në Kosovë dhe e vlerësojnë përkrahjen e vazhdueshme të institucioneve të Kosovës. Gavran është autor i njohur i cili prinë në listën e autorëve më të përkthyer kroatë, tekstet e të cilit kanë depërtuar në rreth 40 gjuhë të botës, ndërsa vetëm në premiera të shfaqjeve kanë arritur një numër me rreth tre milionë shikues.



E jashtëzakonshme

Gjeniu tetëvjeçar belg do ta nisë universitetin

Një djalë belg ka mbaruar shkollën e mesme në moshën tetëvjeçare, pasi më parë kishte përfunduar studimin gjashtëvjeçar në vetëm një vit e gjysmë. Laurent Simons, babai i të cilit është belg dhe nëna holandeze, ka një nivel zgjuarsie (IQ) prej 145 sipas prindërve të tij. Ai arriti së fundmi të diplomohet njësoj me 18-vjeçarët.



FOTO E DITES



Një grua indiane ushqen pëllumba me grurë në Liqenin Pushkar, në shtetin indian të Rajasthan. /AFP/

E rrallë

Peshkaqeni i bardhë shfaqet në Mesdhe pas 30 vjetësh

Një fotografi e jashtëzakonshme është realizuar në detin e ishujve Balear. Aty shihet një peshkaqeni i bardhë dhe është rasti i parë i konfirmuar i këtij lloji në ujërat spanjolle gjatë 30 vjetëve të fundit. Grupi i ekologjistëve



"Alnitak" ka përhapur lajmin. Peshkaqeni, i filmuar nga aktivistët, ishte pesë metra i gjatë dhe ndodhej jashtë ishullit Cabrera.

BARSOLETA E DITËS



I troket Hysenit vdekja në derë:
- Kam ardhur për shpirtin tënd.
Hyseni kthehet dhe bërtet:
- Razë, shpirt, po të lypë dikush.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 15:00

“AVENGERS: Infinity War” 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

“ISLE OF DOGS”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

“DEADPOOL 2” (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjatë vikendit 19 dhe 20 maj, “DEADPOOL 2” do të shfaqet në ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

“I FEEL PRETTY”

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Jeni pak konfuzë sot për shkak të një zhvillimi të papritur, por shumë shpejt do të arrini ta kapni ritmin e ditës.</p>	 <p>DEMI Xhelozë, por jo posesive karshi partnerit, sot do të lejoni të jetë ai që do ta drejtojë lidhjen. Kjo gjë do ta lumturojë pa masë.</p>	 <p>BINJAKËT Përgjegjësitë dhe karriera sot kanë bërë që të grumbulloni shumë stres. Do të kërkonit një moment pauze, por impenjimet nuk do t'ju lënë të qetë.</p>	 <p>GAFORRJA Sot do të zbuloni anët më të mira të karakterit tuaj. Kush ju qëndron pranë do të ketë shumë për të mësuar nga ju.</p>	 <p>LUANI Krenaria dhe ambicia do të tregojnë që ju keni një karakter shumë të vështirë për t'u menaxhuar. Mundohuni t'i zgjidhni këto pengesa tuajat.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Sot po flirtoni dhe po tentoni të joshni një person që ka kohë që ju pëlqen. Bëni të mundur të kënaqeni vetë nga kjo lojë pastaj personi tjetër.</p>
 <p>PESHORJA Kohët e fundit po flisni dhe po debaton vetëm për çështje ekonomike në familje. Kjo tregon që ju ka prekur disi kriza financiare, por shumë shpejt do ta kaloni këtë krizë.</p>	 <p>AKREPI Shumë dashuri rreth jush krijon një ambient dhe atmosferë magjike. Jeni epiqendra e miqve dhe e partnerit sot.</p>	 <p>SHIGJETARI Ndiheni në humor të keq sot dhe kjo gjë ju ka izoluar nga pjesa tjetër e njerëzve. Do të keni një takim të papritur me një person të panjohur më parë.</p>	 <p>BRICJAPI Dita sot do të rrjedhë qetë dhe mbrëmja parashikohet akoma më e mirë. Si shefa kuzhine që jeni mundohuni që sot të ftoni miqtë për darkë.</p>	 <p>UJORI Një boshllëk nga ana sentimentale sot do të arrini ta mbushni vetëm me shpenzime të ekzagjeruara. Si për vete edhe për të tjerët do të bliji gjëra pa fund.</p>	 <p>PESHQIT Nëse pranë vetes keni bashkëpunëtorë të aftë do të arrini të realizoni projekte afatgjata dhe mjaft fitimprurëse për të gjithë.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BELGIUM - JAPAN

1

BRAZIL - MEXICO

1

LILLESTROM - STROMSGODSET

1

Përfunduan Lojërat Mesdhetare, paraqitje e mirë e Kosovës

Kosova ka debutuar suksesshëm në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018", pasi fitoi tri medalje të arta dhe një të argjendtë. Të katër medaljet e fituara janë nga sporti i xhudos, kurse më meritori është trajneri Driton Kuka

PRISHTINË, 1 KORRIK - Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018" janë mbyllur të dielën me ceremoninë e organizuar. Kosova që mori për herë të parë pjesë në këto lojëra, arriti të dalë e suksesshme me katër medalje, tri prej tyre të arta dhe një të argjendtë. Medaljet e fituara Kosovës si zakonisht ia solli ekipi i xhudos në krye me trajnerin Driton Kuka. Xhudistet Distria Krasniqi (-52 kilogramë), Nora Gjakova (-57 kg) dhe xhudisti Akil Gjakova (-73 kg) fituan medaljet e arta, kurse Lorian Kuka (-78 kg) e fitoi medaljen e argjendtë. Shumë afër medaljeve ishin edhe xhudistja Laura Fazliu (-63 kg), karateistja Adelina Rama (-61 kg), si dhe boksierët Dielli Vranoci (-69 kg) e Violant Sylejmani (-60 kg), por ata humbën luftërat kryesore që ua siguronin medaljet e bronzta, sikurse peshëngritësja Leonora Brajshori që doli e katërta dhe e pesta në disiplinën shtytje dhe shkëputje, kategoria -53 kg. Rama, Fazliu, Vranoci e Sylejmani zunë vendet e para. Nga sportistët e tjerë, karateisti Alvin Karaqi, shigjetari Hazir Asllani dhe tenisti Granit Bajraliu kaluan raundin e parë. Nënkampioni ballkanik, Musa Hajdari, ishte i 13-ti nga 18 sosh në disiplinën 800 metra, kurse shenjëtari Nexhat Sahiti, i 15-ti nga 21 pjesëmarrës në disiplinën qitje me pistoletë ajri 10 metra. Të tjerët përfunduan kryesisht në pozitat e fundit,



sikurse në ekipore, volejboli në rërë (femrat), pingpongu (meshkujt) dhe tenisi (meshkujt), që nuk shijuan fitoren. Krahas 40 sportistëve dhe 13 trajnerëve, Kosova në "Tarragona 2018" u paraqit edhe me katër gjyqtarët: Ardian Muhadri (karate), Latif Demolli (boks), Abedin Bahtiri (ping-pong) dhe Valon Nikqi (volejboll në rërë), të cilët përfaqësuan denjësisht Kosovën, duke ndarë drejtësinë edhe në ndeshjet

gjysmëfinale dhe finale. I pranishëm në "Tarragona 2018" për disa ditë ishte edhe ministri për Kulturë, Rini e Sport, Kujtim Gashi, i cili nga afër përkrahi sportistët dhe ishte pjesë e triumfit të tyre. Në përgjithësi mund të vlerësohet se ekipi olimpiq i Kosovës debutoi suksesshëm në shtetin e Spanjës, vend ky që nuk e nje Pavarësinë e Kosovës. Delegacioni i Kosovës arrin sot (e hënë) pasdite në Prishtinë.

Rusia eliminon Spanjën

MOSKË, 1 KORRIK - Pas Gjermanisë, Argentinës dhe Portugalisë, edhe Spanja eliminohet nga Kupa e Botës "Rusi 2018", pas goditjes së penalltive në ndeshjen ndaj Rusisë (3-4). Vendësit nuk mund t'i bënin ballë presionit të shpejtë të Spanjës dhe në një krosim, mbrojtësi Ignashevich e dërgon topin në portën e tij pas një dyluftimi me mbrojtësin Sergio Ramos që në minutën e 12. Deri në këtë fazë të botërorit ky është autogoli i 10 i shënuar në këtë kompeticion. E gjendur kaq herët në disavantazh, aq më tepër ndaj Spanjës, u mendua se Rusia nuk do të arrinte të reagoonte, por ndodhi e kundërta dhe vendësit shkuan disa herë rrezikshëm në portën e De Geas. Përpjekjet e tyre u shpërblyen në minutën e 41-të, kur arbitri akordoi një penallti për prekje me dorë në zonë nga Pique dhe Dzyuba e ktheu në gol, duke bërë që pjesa e parë të mbyllej në barazim 1-1. Në pjesën e dytë, Spanja ishte më kërkuese, por konkretizimi në portën



ruse mungoi dhe rezultati i barabartë mbeti në fuqi deri në përfundim të kohës së rregullt, por edhe të 30 minutave të

shtesës. Te penalltitë ishin rusët që u treguan më të saktë, ndërsa për spanjollët gabuan Koke dhe Aspas.

SHKURT

Milicaj, si Gashi, afër Dukagjinit

Dukagjini nga Klina është duke bërë një plan serioz për rikthimin në elitën e futbollit të Kosovës. Në kuadër të këtij projekti përfshihen edhe dy lojtarët e dëshmuar në futbollin e Kosovës, Dugagjin Gashi dhe Mark Milicaj. Gashi ditë më parë ka konfirmuar për "Epokën e re" se është afër marrëveshjes me këtë klub, kurse gazeta mëson se të njëjtën gjë pritet ta bëjë edhe Milicaj, i cili ishte pjesë e Feronikelit.

Januzaj: Ja pse nuk festova me shqiponjë

Andan Januzaj në një intervistë për mediet belge ka thënë se nuk ka festuar me shqiponjë me arsyen se nuk dëshiron ta përziej futbollin me politikë. "Unë nuk dua ta përziej futbollin me politikën. Unë preferova të festoj me tifozët dhe shokët e mi. Nuk e di mirë se a ishte një nga golat më të mirë në karrierë, por e di se ishte më i rëndësishmi. Unë dua ende të shënoj në këtë Kampionat Botëror. Por, trajner duhet t'i bëjë vendimet e tij", ka thënë Januzaj.

Behrami, kapiten i Zvicrës ndaj Suedisë

Mesfushori shqiptar Valon Behrami do të jetë kapiten i Kombëtares së Zvicrës në duelin e 1/8 së finales kundër Suedisë, njofton "20 min". Behrami do të jetë kapiten në mungesë të të suspenduarit Stephan Lichtsteiner. "Unë jam edhe më krenar që kam veshur këtë fanellë", ka thënë Behrami.

Marquez triumfon në Holandë

Marc Marquez me Honda fitoi garën e Çmimit të Madh të Holandës në Moto GP, zhvilluar në pistën e Assenit, duke thelluar edhe më shumë diferencën me rivalët. Një triumf i vështirë, por i merituar i pilotit spanjoll, në një garë spektakolare dhe me shumë rivaliteti, më e bukura e këtij sezoni, ku emri i fituesit ishte në dilemë deri në kthesën e fundit. Në vendin e dytë u rendit spanjollja Alex Rins me Suzuki dhe në të tretin një tjetër spanjoll, Maverick Vinales me Yamaha. Pas tyre u klasifikuan dy pilotë italianë, me Andrea Dovizioso (Ducati) që la pas Valentino Rossin (Yamaha).

Eliminimi dëshpëron Ronaldon, e ardhmja e paqartë

MOSKË, 1 KORRIK - Ylli portugez i Real Madridit, Cristiano Ronaldo, ka thënë se Portugalia ka luajtur më mirë se Uruguai në ndeshjen e 1/8 së finales. Kapiteni ndihet krenar me paraqitjet në Rusi. "Luajtëm më mirë se Uruguai, meritoni më shumë, por ky është futboll. Fiton ai që shënon më shumë. Si kapiten, jam krenar për

këtë grup, për punën e bërë. Punuam fort, të gjithë, lojtarë dhe stafi", ka thënë Ronaldo. Ndërsa për të ardhmen Ronaldo ka thënë se nuk është momenti i duhur për të folur. "Largohem nga ky Botëror, i bindur se dhashë më të mirën, edhe pse nuk shkuam aty ku dëshironim. Por, kjo kombëtare do të vazhdojë të fitojë.

Për sa i përket së ardhmes sime, ky nuk është momenti i duhur për të folur për vete, as për shokët e skuadrës apo trajnerin. Kjo kombëtare mbetet nga më të mirat në botë dhe do të vazhdojë të triumfojë, pasi ka lojtarë të mëdhenj, një grup fantastik, që ka ambicie për të shkuar larg", ka deklaruar Ronaldo.



Brazili dhe Belgjika në kërkim të çerekfinales

MOSKË, 1 KORRIK (ER) - Brazili është në rrugë të mbarë për ta ndrequr historinë e Kupës së Botës në vitin 2014, kur zhgënjeu përtej mase të gjithë adhuruesit e saj me eliminim, por edhe me humbjen e thellë nga Gjermania (7-1). Brazilianët nuk e nisën mirë këtë kampionat, pasi barazuan me Zvicrën në ndeshjen e parë 1-1, por më pas u këndellën dhe e mposhtën Kosta Rikën (1-0) dhe Serbinë (2-0). Tash përballë reprezentacionit brazilian është Meksika që startoi fuqishëm në këtë Botëror, duke e mposhtur kampionen e Botës, Gjermaninë (0-1), më pas edhe Korenë e Jugut (1-2), por në ndeshjen e fundit ndaj Suedisë pësuan humbje të thellë me rezultat 3-0. Brazili konsiderohet favorit, pasi ka shumë yje në skuadër dhe vëmendja është tek Neymar, i cili nuk ka arritur të shkëlqejë deri tash. Ai që ka shkëlqyer deri tash është ylli i Barcelonës, Philippe Coutinho, që është i gatshëm ta vazhdojë kontributin në fanellën e kombëtares.



Brazili në këtë ndeshje do të mundohet të mos lejojë befasi, kurse Meksika do t'i provojë shanset e saj për të arritur në çerekfinale. Për Brazilin i gatshëm pritet të jetë Marcelo, i cili pësoi një lëndim në ndeshjen ndaj Serbisë, derisa në formacion parashikohet të jetë edhe Danilo. Douglas Costa është në dyshim për ndeshjen ndaj Meksikës, kurse meksikanët do të jenë pa Hector Morenon që mungon shkaku i kartonëve dhe

vendin e tij pritet ta zë Hugo Ayala. Ndërsa ndeshja tjetër që zhvillohet sonte është ajo në mes të Belgjikës dhe Japonisë. Belgët që e mposhtën Anglinë me formacion të dytë dhe falë golit të shqiptarit, Adnan Januzaj, janë favoritë ndaj Japonisë që u kualifikua në 1/8 e finales në saje të lojës "far-paly".

TË HËNËN TAKOHEN:
16:00 Brazili-Meksika
20:00 Belgjika-Japonia

Verstappeni fitoi Çmimin e Madh të Austrisë

VJENË, 1 KORRIK - Max Verstappen me Red Bullin fitoi garën e Çmimit të Madh të Austrisë në Formula 1, e cila u zhvillua në pistën e Zwerlitz. Në vendin e dytë dhe të tretë u klasifikuan dy pilotët e Ferrarit, me Kimi Raikkonen që la pas shokun e skuadrës Sebastian Vettel. Një garë për t'u harruar kjo për makinën Mercedes, pasi Valtteri Bottas, që të shtunën siguroi "pole", u tërhoq shumë shpejt për probleme në kambio, ndërsa Lewis Hamiltoni u tërhoq për probleme në motor 7 xhiro nga fundi, duke humbur edhe kreun e renditjes, aty ku rikthehet Vetteli. Starti i garës dhuron mjaft surpriza, me Hamiltonin që merr menjëherë kreun, por vendimtar në këtë garë ishte momenti ku komisarët vendosën regjimin e makinës së sigurisë virtuale pas një aksidenti të Hulkenberg në xhiron e 17. Të gjithë pilotët e kreut (Verstappen, Raikkonen, Ricciardo e Vettel) hynë për t'i ndërruar gomat, por jo Hamiltoni që e kryen këtë gjë disa xhiro më vonë dhe humbet kreun.



Por kjo strategji nuk i jep sukses pilotit britanik, që në mesin e garës parakalohet edhe nga Vetteli, i vetmi nga pilotët "big" që ishte pas tij. Mercedesi kishte probleme, Hamilton nuk është i shpejtë dhe 7 xhiro nga fundi tërhoqet për probleme në motor, ndërkohë që më herët ishte tërhoqur edhe Ricciardo (Red Bull). Mjaft interesante bëhen edhe xhirot e fundit të garës, me dy pilotët e Ferrarit që tentojnë të rikuperojnë karshi Verstappen, e ngush-

tojnë ndjeshëm diferencën, por pa sukses. Piloti holandez administron avantazhin dhe triumfon me meritë, korr suksesin e 4-t në karrierën e tij dhe nis festën para fansave të shumtë që kishin ardhur për ta mbështetur. Mirë u paraqit Ferrari, në podium me të dy pilotët, ndërkohë që në "top-10" u klasifikuan edhe Grosjean, Magnussen, Perez, Ocon, Alonso, Ericsson e Leclerc, që hynë në zonën e pikëve. Gara e radhës, pas një javë në Angli (pista e Silverstone).

SHKURT

Kroosi refuzon Unitedin

Toni Kroos nuk është i gatshëm të largohet nga Real Madridi për t'iu bashkuar Manchester Unitedit. Lajmin e ka konfirmuar e përditshmja spanjolle "Mundo Deportivo", sipas së cilës, lojtari ka një kontratë me skuadrën madrilene që skadon në verën e vitit 2022 dhe preferon ta respektojë atë, duke qëndruar në Spanjë. "Do të qëndroj këtu deri në vitin 2022", ka thënë Kroos, i cili pëlqehet nga trajneri i Manchester Unitedit, Jose Mourinho, por edhe nga Pep Guardiola i Manchester Cityt.

Manaj transferohet te Albacete

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Rey Manaj, nuk është më lojtar i Interit. Ai ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare me skuadrën e Albacetes në Spanjë, kurse më herët ka luajtur edhe për Granadën, Pisën, Pescaran dhe Cremonesen.

Pensionohen Mascherano dhe Biglia

Pas eliminimit të Argjentinës nga Kupa e Botës, Javier Mascherano dhe Luca Biglia janë pensionuar nga kombëtarja. Fillimisht pensionimin e zyrtarizoi ish-mesfushori i Barcelonës, Javier Mascherano, që ka luajtur 147 ndeshje për Argjentinën, kurse më pas të njëjtën gjë e bëri edhe mesfushori i Milanit, i cili u paraqit për këtë kombëtare në 58 ndeshje.

Paul George nuk largohet nga Oklahoma

Paul George ka befasuar të gjithë opinionin e basketbollit në Amerikë. Ai ishte i lirë pas skadimit të kontratës me skuadrën e Oklahoma City Thunder. E të gjithë prisnin se ai do të rikthehet në qytetin e lindjes, në Los Angeles, por diçka e tillë nuk ndodhi. 28-vjeçari ka befasuar të gjithë duke vazhduar kontratën me Oklahoma City Thunderin edhe për katër vjet të tjera. George ka marrë kontratë maksimale sa i përket pagës vjetore. Për katër vjetet e ardhshme George në Oklahoma do të marrë 137 milionë dollarë. Kësajsoj basketbollisti amerikan bëhet ndër më të paguarit në ligën më të fortë të basketbollit në botë NBA.

Jamesi do të luajë ndaj Anglisë

Mesfushori i Kolumbisë, James Rodriguez, pritet të luajë në ndeshjen ndaj Anglisë, e vlefshme për 1/8 e finales në Kupën e Botës. Ylli i Bayernit është lënduar pas gjysmë ore lojë në ndeshjen ndaj Senegalit, por analizat mjekësore kanë konstatuar se ai ka vetëm lodhje muskulore. Ndeshja në mes të Kolumbisë dhe Anglisë zhvillohet të martën nga ora 20:00.

Cavani synon finalen e Botërorit

Sulmuesi Edison Cavani ishte lojtari i ndeshjes ndaj Portugalisë, pasi realizoi dy golat e fitores (2-1). Ai ka bërë me dije se ëndrra e Uruguaimit është kualifikimi deri në finale. "Jam shumë i lumtur, shumë i kënaqur për atë që kemi arritur. Është një ndjesi e bukur, loja për ne vazhdon. Është një moment shumë emocionues për mua, më mungojnë fjalët. Mund ta imagjinoj se çfarë bëhet në Uruguai pas fitores. Shpresoj të vinim përpara dhe të shkojmë deri në fund", ka thënë Cavani.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.545/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Faton Ademi në qështjen juridike të paditësit: Mehmet Dobra nga Mitrovica të cilin e përfaqëson: Ubejd Gashi nga zyra juridike "Juristi" kundër të paditurve: Aleksic Ljuba ish nga Mitrovica tani me vendqëndrim të panjohur dhe Komuna e Mitrovicës, gjykata me datën: 14.06.2018 konform nenit 79.3 të LPK-së mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Caktohet Av. Valon Hajdini nga Mitrovica si përfaqësues i përkohshëm i të paditurit: Aleksic Ljuba ish nga Mitrovica tani me adresa të panjohura.

II. Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim në afat prej shtatë ditësh të shpallet në tabelën e shpalljes së gjykatës, të botohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe te botohet në njëren nga gazetatat ditore të Kosovës apo sipas nevojës të shpallet në ndonjë menyrë tjetër të përshtatshme.

IV. Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm bien në barë palës paditëse.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.402/2016

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Faton Ademi në qështjen juridike të paditësve: Ferat Berani dhe Fevzije Berani nga Mitrovica të cilët i përfaqëson Ubejd Gashi nga Zyra juridike Juristi kundër të paditurve: Mejreme Berani nga Prishtina tani me adresë të panjohur në Itali, Hixhrije Berani me adresë të panohur në Gjermani, Nuhi Berani, Mybera Berani me adresë të panjohur në Gjermani dhe Kiziban Berani nga Mitrovica, gjykata me datën: 07.06.2018 konform nenit 79.3 të LPK-së mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Caktohet Av. Sabit Pllana nga Mitrovica si përfaqësues i përkohshëm i të paditurave: Mejreme Berani, Hixhrije Berani dhe Mybera Berani ish nga Mitrovica tani me adresa të panjohura ne Itali respektivisht në Gjermani.

II. Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim në afat prej shtatë ditësh të shpallet në tabelën e shpalljes së gjykatës, të botohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe te botohet në njëren nga gazetatat ditore të Kosovës apo sipas nevojës të shpallet në ndonjë menyrë tjetër të përshtatshme.

IV. Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm bien në barë palës paditëse.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

GJYKATA THEMELORE
C.nr.45/2015
Me dt. 25.06.2018
Mitrovicë

PRISHTINË

Ne bazë të nenit 83 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të Kosovës kërkojmë të publikoni këtë,

SHPALLJE

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, në qështjen juridike të paditësit : Faik Goxhuli nga Mitrovica , kundër të paditurit: Ramadan Latif Bajrami nga Mitrovica , tani me vendbanim te panjohur baza e kontestit:Vertetim pronsie , ne baze te nenit 79 pika 3-a e Ligjit mbi Proceduren Kontestimore te Kosoves te paditurit: Ramadan Latif Bajrami i caktohet perfaqesuesi I perkoheshem - Avokati Xhemajl Jusufi nga Mitrovica.

Përfaqësuesi i përkohshëm do ta përfaqësoj të paditurin në këtë çështje juridike deri sa ai apo i autorizuari i tij të paraqitet në këtë gjykatë.

GJYQTARI,
Ragip Kadriu

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllashi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Trullin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Trullin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Agjencia Kosovare e Privatizimit është e ngarkuar për të privatizuar Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë përmes metodës së spin-off-it dhe likuidimit. Investitorët ftohen t'i blejnë përmes tenderit të hapur dhe konkurrues asetet e disa NSH-ve në likuidim të radhitura më poshtë.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
SHPLL SHITJEN E 39-të TË ASETEVE TË NDËRMARRJEVE NË LIKUIDIM

Subjektet / njësitë e përcaktuara më poshtë janë nën juridiksionin e AKP-së në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-034 për Privatizim mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ofertat e mbyllura për njësitë në vijim duhet të dorëzohen në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve më **1 gusht 2018**, ndërmjet orës **10:00 dhe 12:00** në Prishtinë (sipas kohës lokale të Evropës Qendrore), dhe të shoqëruara nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, siç është parashikuar për secilin artikull. Të gjitha ofertat duhet të paraqiten në përputhje me Rregullat e Tenderit të zbatueshme për shitjet me likuidim. Të gjitha njësitë e radhitura këtu ofrohen për shitje mbi bazën “siç është” dhe “ku është” dhe do të shiten në përputhje me termet ligjore dhe kushtet e shitjes. Veçanërisht dhe pa ndryshuar kushtet e tilla, AKP nuk jep garanci, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, sa i përket gjendjes apo përshkrimit të njësive që shiten ose përshatshmërisë së tyre për ndonjë përdorim apo qëllim. Verifikimi i përshkrimit dhe gjendjes së të gjithë njësive të listuara këtu është përgjegjësi e ofertuesit.

